



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në  
“Bashkinë Krujë”

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**

**“Audimin e Përputhshmërisë ”**

**Tiranë Dhjetor 2017**

## **I.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

### **II. HYRJA (Të dhëna mbi Projektin e Auditimit)**

a. Objektivat dhe qëllimi	1
b. Identifikimi i çështjes	2
c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	2
d. Përgjegjësitë e audituesve	2
e. Kriteret e vlerësimit.	3
f. Standardet e auditimit.	3-4

### **III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT** 4-42

### **IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET** 42-48

- a. Drejtimi/Pika 1 e Programit të Auditimit  
*Menaxhimi Financiar*  
Drejtimi/Pika 2 e Programit të Auditimit  
Mbi zbatimin e buxhetit  
Drejtimi/Pika 3 e Programit të Auditimit  
Mbi përputhshmërinë e procesit transferimit.
- b. Drejtimi/Pika 4 e Programit të Auditimit.  
Opinion e efektivitetit e Reformës Territoriale  
Drejtimi/Pika 5e Programit të Auditimit
- c. Drejtimi/Pika 5 e Programit të Auditimit
- d. Të tjera.

### **IV. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT**

### **V. ANEKSE**

### **VI. DOKUMENTE SHOQËRUESE**

- a. Akt konstatime:** *30 faqe*
  - 1. Akt Konstatimi nr.1, datë 18.09.2017 “Për objekte e pasuri te shkatërruara e zaptuara”
  - 2. Akt Konstatimi nr.2, datë 28.09.2017 “ Transferimi i personelit”
  - 3. Akt Konstatimi nr.3, datë 2809.2017 “Për transferimin arkivave dhe punonjësve”
  - 4. Akt Konstatimi nr.4, datë 28.09.2017 “Për transferimin arkivave dhe punonjësve”

- b. Akt verifikime** *44 faqe*
  - 1. Akt verifikim nr.1, datë 15.09.2017 “Për verifikimin për zbatimin e MFK”
  - 2. Akt verifikim nr.2, datë 15.09.2017 “Për verifikimin për zbatimin e MFK”

- |  |
|--|
| 3. Akt verifikim nr.3, datë 15.09.2017 “Për verifikimin zbatimin e MFK”                        |
| 4. Akt verifikim nr.4, datë 15.09.2017 “Për verifikimin zbatimin e MFK”                        |
| 5. Akt verifikim nr.5, datë 15.9.2017 “Për verifikimin zbatimin MFK”                           |
| 6. Akt verifikim nr.6, datë 25.09.2017 “Për zbatimin e procedurave të bashkimit të NJSH-ve”    |
| 7. Akt verifikim nr.7, datë 5.10.2017 “Për verifikimin për mos transferimin e arkivit”         |
| 8. Akt verifikim nr.8, datë 5.10.2017 “Për verifikimin e planifikimit buxhetit”                |
| 9. Akt verifikim nr.9, datë 05.10.2017 “Për verifikimin e bashkimit të aktivitetit të NJSH-ve” |
| 10 Akt verifikim nr.10, datë 06.10.2017 “Për verifikimin e mbi efektet e reformes”             |

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 776/1, datë 24/7/2017 miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 25.07.2017 deri në datë 6.10.2017, në subjektin Bashkia Krujë për periudhën nga 01.01.2014 deri në datë 31.12.2016, u krye auditimi **“Dhënien e një opinionit objektiv, profesional e të pavarur mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve, si dhe auditimin e përgjegjësisë financiare, vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret.**

Grupi i Auditimit me përbërje:

1. V.V. (Përgjegjës Grupi)
2. R.K. Auditues
3. M.B. Auditues

a) **Titulli.** Zbatimi i Procedurave për Transferimin e të Drejtave dhe Detyrimeve, të prekura nga Riorganizimi Administrativo-Territorial në Bashkinë Krujë, sipas VKM nr.510, datë 10.6.2015.

b) **Marrësi.** Kryetari i Bashkisë Krujë, z.A.B.

## OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

**-Objekti i auditimit.** Lidhur me zbatimin rregullshmërisë dhe ligjshmërisë në Bashkinë Krujë për zbatimin e reformes territoriale pas miratimit të procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve nga riorganizimi administrativo-territorial.

Sipas ndarjes administrative të përcaktuara në ligjin nr.115/2014, Bashkitë pasi u konstituan duhet të zbatonin procedurat për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personeli, arkivave dhe aktiveve të trupëzuara dhe pa trupëzuara sipas afateve të përcaktuara në VKM nr.510, datë 10.6.2015.

**Qëllimi i auditimit.** Dhënien e një opinionit objektiv, profesional e të pavarur mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti të rregullave, ligjeve, vendimeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve, lidhur me procedurat e ndjekura nga riorganizimi administrativo-territorial i Bashkisë Krujë si dhe auditimin e përgjegjësisë financiare, vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret.

**Identifikimi i çështjes.** Projekt Raporti mbi veprimtarinë e (Njesit vendore të shpërbera ) në vazhdim NJSH-të të Bashkinë Krujë, mbi zbatimin e procedurave gjatë riorganizimit administrativo-territorial, në këtë Bashki.

**Përgjegjësitë e audituesve.** Në Raport e Auditimit janë shprehur konkluzionin dhe një opinion mbi çështjen që është në auditim (Përputhshmerinë). Auditimi është kryer në zbatim të “Manuali i Auditimit të Përputhshmerisë” si dhe udhëzimeve dhe rregullave të nxjerra në zbatim të tyre, sipas standardeve të auditimit , në përputhje Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t” (ISSAI), “Manuali i Auditimit të Përputhshmerisë” si dhe udhëzimeve dhe rregullave të nxjerra në zbatim të tyre.

Udhëzimi i Kryetarit të KLSH nr.1, datë 04.11.2016 “Mbi Procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës, në auditimin e verifikimit zbatimit rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

**k. Kriteret e vlerësimit.** Për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit jemi mbështetur në Ligji nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar me ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (neni 13/ 5, neni 43 pika 1);

Ligji nr.115/2014 datë 31.07.2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të Njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar me ligjin nr.110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;

Udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**h. Standardet e auditimit,** të aplikuara në kryerjen e punës. Për hartimin e Raporti Përfundimtarë, janë ndjekur Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t” (ISSAI), “Manuali i Auditimit të Përputhshmerisë” si dhe udhëzimeve dhe rregullave të nxjerra në zbatim të tyre.

Udhëzimi i Kryetarit të KLSH nr.1, datë 04.11.2016 “Mbi Procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës, në auditimin e verifikimit zbatimit rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Rregullorja e Brendshme mbi Organizimin dhe Funksionimin Administrativ të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH, Nr. 85, datë 30.06.2015;

### **III . PËRSHKRIMI AUDITIMIT**

1. Në zbatim të programit të Auditimit nr. 776/1, datë 24/7/2017, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 25.07.2017deri në datë 06.10.2017 grupi i auditimit pas njoftimit që i është bërë Bashkisë bëri prezantimin e auditimit që do kryente në Bashkinë Krujë dhe pasi u sistemua në ambientet e kësaj Bashkie, filloj njohjen me dokumentacionin që u vu në dispozicion nga punonjësit e administratës dokumentacioni që disponohet lidhur me zbatimin procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit,arkivave ,aseteve të trupëzuara dhe pa trupëzuar si dhe çdo dokument tjetër zyrtar të Njësitë vendore, të përfshira nga riorganizimi Administrativo-territorial.

Nga verifikimi i zbatimit të procedurave për transferimin e NJSH-ve, konstatuam probleme lidhur me mos funksionimin e Grupit të Punë të ngritur pranë Bashkisë Krujë për të siguruar zbatimin e transferimit të drejtave dhe detyrimeve në zbatim të Kreut II, të VKM nr.510, datë 10.6.2015, duke mos raportuar tek Kryetari i Bashkisë për punën e kryer dhe mungesën e informimit të me shkrim për realiyimin e detzrave të ngarkuara.

Nuk disponohej informacion nga ky grup lidhur me detyrat që kishte që të zbatonte, lidhur me regjistrimin e pronave, transferimin e arkivave të NJSH-ve, etj.

Të dhënat janë siguruar në zyrat e administratës së Bashkisë dhe njësive Administrtive

Vendore.

## **2.Objekti,qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit.**

**a.** Objekt i këti auditimit është i lidhur me zbatimin regullshmërisë dhe ligjshmërisë në Bashkinë Krujë për zbatimin e reformës territoriale pas miratimit procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve nga riorganizimi administrativo-territorial.

Sipas ndarjes administrave të përcaktuara në ligjin nr.115/2014, Bashkitë pasi u konstituuan duhet të zbatonin procedurat për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personeli, dokumentet arkivore dhe aktiveve të trupëzuara dhe pa trupëzuara sipas afateve të përcaktuara në VKM nr.510, datë 10.6.2015.

**b. Qëllimi i auditimit.** Në përmbledhje të problematikave të konstatuara më lartë si dhe akteve të tjera të mbajtura në sektorë të ndryshëm të Bashkisë Krujë, konstatohet se si para reformës territoriale, ashtu edhe pas konstituimit të bashkisë së re, nga drejtuesit e njësive vendore, e trashëguar kjo edhe me titullarin e Bashkisë së re, janë shkelur procedurat e tranzicionit si dhe ligjshmërisë për menaxhimin financiar.

- Reforma territoriale, referuar treguesve financiar dhe indikatorëve të tjerë ligjor, ka dhënë ndonjë imput pozitiv në të ardhurat vendore, por ka thelluar humbjet në buxhetin bashkiak, nga keq menaxhimi i aseteve, shkatërimi i pronës etj.

- Nga raporti i ndërsjellët i Menaxherit kryesor, me menaxherët e tjerë, paraqitet një situatë ku spikasin shkeljet e parimeve të menaxhimit financiar, transparencës në administrim. Pa përgjegjshmëria lidhur me ndarjen e detyrave brenda departamenteve, ka sjell për pasojë keq menaxhimin e haseteve dhe mos kontrollin e tyre.

**c. Fushëveprimi.** Duke konstatuar se nuk janë zbatuar procedura e transferimit të punonjësve nga riorganizimi administrativo- territorial, si dhe të largimit punonjesve sipas përcaktimeve ligjore, përdorimin e të ardhurave dhe dhe shpenzimeve në fushën e pagave dhe shpenzimeve operative, në mos arketimin e të ardhurave të planifikuara u audituan pjesë të buxhetit që kanë lidhje me to. Nga auditimi rezultoj se janë tejkaluar shpenzimet për pagat si rezultat i mos zbatimit të procedurave të transferimit saktë të përcaktuara në VKM nr.510, datë 10.6.2015, si dhe nuk është kryer inventarizimi dhe regjistri e aktiveve të luajtshme dhe pa luajtshme, gjë që sjell tkurrjen e të ardhurave.

## **IV.GJETJE DHE REKOMANDIME**

### **I. MENAXHIMI FINANCIAR DHE KONTROLLI I BRENDSHËM.**

Nga Titullari i njësisë publike, nuk janë vendosur, përmbushur qëllimet dhe objektivat e njësisë publike, në përputhje me kërkesat e ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” nëpërmjet veprimtarive efektive, eficientë dhe me ekonomi, pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat, informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota dhe mbrojtjes së informacionit e të aktiveve. *Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli i Brendshëm për vitet 2014, korrik 2015, në ish Bashkin Fush-Krujë dhe në NJSh-të Thumanë, Bubq, Nikel, Cudhi, sot egzistojnë si Njësi Administrative”* .

**Nga verifikimi rezultoi që:** Nuk janë dërguar në Ministrinë e Financës, Deklarata për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm si dhe pyetësori i vetëvlerësimit.

Nuk ka funksionuar plani për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe metodologjia për zbatimin e tij.

Nuk janë ngritur nga Kryetari i Bashkisë, personi Autorizues i Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe nuk ka miratuar kalendarin e punës për programin buxhetor afatmesëm.

**b.Organizimi i procesit.** Hartimi i deklaratës së vizionit dhe misionit si dhe i objektivave themelore të aktivitetit. Plani strategjik, miratimi dhe monitorimi i tij. Nga auditimi **vlerësojmë se:**-Në pikën I, nuk ka ndonjë udhëzim të veçantë ku punonjësve tu kërkohen vlerat etike, marrëdhëniet e sjelljes me eprorët, konfliktet e mundshme të interesave si dhe sjelljet me publikun, *(nuk ka të miratuar kod etike)*.

**-Në pikën II**, nuk pasqyrohet me përshkrim vlerësimi i 5 komponentëve të Sistemit të MFK-së, në ish Bashki Fush-Krujë dhe 4 ish Komunat. Në pikën III *(Gjetje dhe rekomandimet e Auditit të brendshëm dhe të jashtëm)*, ish Bashkia Fushë-Krujë, nuk ka patur strukturë të auditimit të brendshëm në strukturën organizative të saj, por auditimin e veprimtarisë e ka realizuar në marrëveshje me strukturën e auditimit të Prefekturës Durrës.

**-Në pikën IV, lidhur me (Masat për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm) nuk ka raportime.**

-Në këtë Bashki nuk ka ndonjë udhëzim të shkruar lidhur me mënyrën e komunikimit brenda përbrenda njësisë (komunikim me shkrim elektronik, verbal).

-Sistemi i IT-së nuk funksionon.

-Nuk disponohet një program trajnimesh për punonjësit e kësaj njësie, megjithëse një program i tillë do të ishte i nevojshëm dhe me impakt pozitiv.

Nga auditimi i *përgjigjeve të Pyetësorit të vetëvlerësimit* “Për Funksionimin e Sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për vitin 2014-2015,” dhe nga dokumentacioni i afruar, konstatohen mangësitë si më poshtë:

-Nuk janë përcaktuar Objektivat, Misioni dhe Vizioni Bashkisë dhe nuk informohen si duhet menaxherët dhe punonjësit e njësisë publike në lidhje me përmbajtjen e deklaratës së misionit, objektivave dhe të strategjisë. Gjithashtu plani strategjik i zhvillimit afat mesëm e afatgjatë, plani i veprimit afat shkurtër dhe objektivat nuk paraqiten.

-*Pyetësori nuk është plotësuar* në mënyrë të plotë në rubrika, mungojnë komentet dhe dokumentet bashkëlidhur tij, pyetësori duhet të pasqyroj me vërtetësi dhe sinjeritet realitetin e vlerësimit të gjendjes së sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

-Përgjigjet e pyetësorit duhej dhënë në formë të plotë, duhej të ***përshkruheshin sqarimet në kolonën “Komente***, për secilën nga përgjigjet.

-Në kolonën e vlerësimit me pikë për 5 seksionet ***vlerësimi i pikëve duhej vendosur në mënyrë korrekte, për të gjithë pyetësoin.***

-***Mjedisi i Kontrollit***, nga ana e Bashkisë nuk është përfshirë në rregulloren e brendshme të Bashkisë të miratuar në Këshillin e Bashkisë.

-***Vetëvlerësimi nuk janë plotësuar sipas referimeve pyetjeve dhe komenteve si dhe dokumentacionit përkatës.***

-***Menaxhimi i Riskut***, nuk janë hartuar nga ana e Titullarit të Bashkisë dhe as nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë identifikimin e riskut.

-***Informimi dhe komunikimi merret nëpërmjet takimeve ditore dhe planeve mujore për secilin sektor.***

-***Monitorimi***, ky aspekt i menaxhimit financiar nuk kuptohet mirë dhe nuk funksionon si duhet.

Me gjendjen e paraqitur më sipër nuk jepet një vlerësim mesatar për 5 komponentët, çka do të thotë se aspektet e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, kuptohen pjesërisht dhe nuk funksionojnë në të gjitha hallkat e Bashkisë. dhe se Titullari i Bashkisë duhet të shikojë mundësinë për të bërë programet e mësipërme.

Mungesa e plotësimit tërësor dhe pasaktësitë në plotësimin e këtij pyetësori vjen nga mos shfrytëzimi i broshurës dhe i udhëzimeve përkatëse, ku përshkruhen konceptet kryesore të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, pra nga mos zbatimi i udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 1615, datë 12.02.2010 në procesin e plotësimit të këtij pyetësori.

***Formulimi, implementimi dhe monitorimi i vlerave të njësisë dhe i kodit të etikës.***

Nga auditim konstatohet se ky komponent vlerësohet si jo i përmbushur, pasi **është** miratuar Rregullorja Brendshme e Bashkisë, por **nuk është** hartuar dhe miratuar Kod Etik për Institucionin dhe strukturat në veçanti, në përputhje me nenin 20, “Mjedisi i kontrollit”, të ligjit” nr. 10296, datë 8.7.2010.

***-Mbikëqyrja e vendimeve dhe veprimeve të menaxherëve.***

Nga auditimi u konstatua se nuk është realizuar mbikëqyrja e vendimeve dhe veprimeve të menaxherëve.

***-Realizimi i sistemit për marrjen e masave korrektuese dhe raportimin e rezultateve.***

Nga auditimi u konstatua se pohohet realizimi i sistemit për marrjen e masave korrektuese dhe raportimin e rezultateve në komunë, por nuk ka dokumentacione lidhur me pasqyrimin e këtij komponenti të MFK.

*Për mos zbatimin e kërkesave sipas ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ngarkohet me përgjegjësi ish titullari i Bashkisë Fush-Krujë z.Gj.B. dhe si punonjësi autorizues.*

***Objekti i këtij aktverifikimi është: Mungesa e sistemit kontrollit të brendshëm në ketë njësi vendore.***

***NJSH –ja,Thumanë ‘Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli i Brendshëm për vitet 2014, korrik 2015,në ish Kryetari Komunës Thuman, sot egzistojnë si Njësi Administrative’.***

***Nga verifikimi rezultoi që:***

-Janë dërguarë në Ministrinë e Financës, Deklarata për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm si dhe pyetsorin e vetëvlerësimit për vitin 2014-2015.

-Nuk ka funksionuar plani për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe metodologjia për zbatimin e tij.

-Nuk janë ngritur nga Kryetari i Komunës , personi Autorizues ***Grupet e Menaxhimit Strategjik (GMS)*** dhe nuk ka miratuar kalendarin e punës për programin buxhetor afatmesëm.

***b.Organizimi i procesit. Hartimi i deklaratës së vizionit dhe misionit si dhe i objektivave themelore të aktivitetit. Plani strategjik, miratimi dhe monitorimi i tij.***

Nga auditimi vlerësojmë se:

-Në pikën I nuk ka ndonjë udhëzim të veçantë ku punonjësve tu kërkohen vlerat etike, marrëdhëniet e sjelljes me eprorët, konfliktet e mundshme të interesave si dhe sjelljet me publikun, (***nuk ka të miratuar kod etike***).

-Në pikën II nuk pasqyrohet me përshkrim vlerësimi i 5 komponentëve të Sistemit të MFK-së, në ish Bashkin Fushë-Krujë .

***-Në pikën III (Gjetje dhe rekomandimet e Auditit të brendshëm dhe të jashtëm), ish Komuna Thuman, nuk ka patur strukturë të auditimit të brendshëm në strukturën organizative të saj.***

-Në pikën IV lidhur me (*Masat për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm*) nuk ka raportime.

-Në këtë Komunë nuk ka ndonjë udhëzim të shkruar lidhur me mënyrën e komunikimit brenda përbrenda njësisë (komunikim me shkrim elektronik, verbal).

-Sistemi i ITI-së nuk funksionon.

-Nuk disponohet një program trajnimesh për punonjësit e kësaj njësie, megjithëse një program i tillë do të ishte i nevojshëm dhe me impakt pozitiv.

Nga auditimi i *përgjigjeve të Pyetësorit të vetëvlerësimit* “Për Funkcionimin e Sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për vitin 2014-2015,” dhe nga dokumentacioni i afruar, konstatohen mangësitë si më poshtë:

-Nuk janë përcaktuar Objektivat, Misioni dhe Vizioni Komunës dhe nuk informohen si duhet menaxherët dhe punonjësit e njësisë publike në lidhje me përmbajtjen e deklaratës së misionit, objektivave dhe të strategjisë. Gjithashtu plani strategjik i zhvillimit afat mesëm e afatgjatë, plani i veprimit afat shkurtër dhe objektivat nuk paraqiten..

**-Pyetësi nuk është plotësuar** në mënyrë të plotë në rubrika, mungojnë komentet dhe dokumentet bashkëlidhur tij, pyetësi duhet të pasqyroj me vërtetësi dhe sinqeritet realitetin e vlerësimit të gjendjes së sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

-Përgjigjet e pyetësorit duhej dhënë në formë të plotë, duhej të *përshkruheshin sqarimet në kolonën “Komente*, për secilën nga përgjigjet.

-Në kolonën e vlerësimit me pikë për 5 seksionet *vlerësimi i pikëve duhej vendosur në mënyrë korrekte , për të gjithë pyetësin.*

**-Mjedisi i Kontrollit**, nga ana e Komunës nuk është përfshirë në rregulloren e brendshme të Komunës të miratuar në Këshillin e Komunës.

**-Vetëvlerësimi nuk janë plotësuar sipas referimeve pyetjeve dhe komenteve si dhe dokumentacionit përkatës.**

**-Menaxhimi i Riskut**, nuk janë hartuar nga ana e Titullarit të Komunës dhe as nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë identifikimin e riskut.

**-Informimi dhe komunikimi merret nëpërmjet takimeve ditore dhe planeve mujore për secilin sektor.**

**-Monitorimi**, ky aspekt i menaxhimit financiar nuk kuptohet mirë dhe nuk funksionon si duhet.

Me gjendjen e paraqitur më sipër nuk jepet një vlerësim mesatar për 5 komponentët, çka do të thotë se aspektet e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, kuptohen pjesërisht dhe nuk funksionojnë në të gjitha hallkat e Komunës dhe se Titullari i Komunës duhet të shikonte mundësinë për të bërë programet e mësipërme.

Mungesa e plotësimit tërësor dhe pasaktësitë në plotësimin e këtij pyetësi vjen nga mos shfrytëzimi i broshurës dhe i udhëzimeve përkatëse, ku përshkruhen konceptet kryesore të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, pra nga mos zbatimi i udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 1615, datë 12.02.2010 në procesin e plotësimit të këtij pyetësi.

#### ***Formulimi, implementimi dhe monitorimi i vlerave të njësisë dhe i kodit të etikës.***

Nga auditim konstatohet se ky komponent vlerësohet si jo i përmbushur, pasi është miratuar Rregullorja Brendshme e Komunës, por **nuk është** hartuar dhe miratuar Kodi Etik për Institucionin dhe strukturat në veçanti, në përputhje me nenin 20, “Mjedisi i kontrollit”, të ligjit” nr. 10296, datë 8.7.2010.

**-Mbikëqyrja e vendimeve dhe veprimeve të menaxherëve.**

Nga auditimi u konstatua se nuk është realizuar mbikëqyrja e vendimeve dhe veprimeve të menaxherëve.

**-Realizimi i sistemit për marrjen e masave korrektuese dhe raportimin e rezultateve.**

Nga auditimi u konstatua se pohohet realizimi i sistemit për marrjen e masave korrektuese dhe raportimin e rezultateve në ish Komunën Thuman, por nuk ka dokumentacione lidhur me pasqyrimin e këtij komponenti të MFK.

***Për mos zbatimin e kërkesave sipas nenit 29 të ligjit nr. 10296 datë, 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ngarkohet me përgjegjësi ish titullari i Komunës Thuman dhe si punonjësi autorizues.***

***NJSH-ja Bubq***, sot egziston si Njësi Administrative Vendore”.

**Nga verifikimi rezultoi që:**

-Janë dërguarë në Ministrinë e Financës, Deklarata për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm si dhe pyetësin e vetëvlerësimit për vitin 2014-2015.



-Nuk ka funksionuar *plani për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe metodologjia për zbatimin e tij.*

-Nuk janë ngritur nga Kryetari i Komunës , personi Autorizues **Grupet e Menaxhimit Strategjik (GMS)** dhe nuk ka miratuar kalendarin e punës për programin buxhetor afatmesëm.

**b.Organizimi i procesit. Hartimi i deklaratës së vizionit dhe misionit si dhe i objektivave themelore të aktivitetit. Plani strategjik, miratimi dhe monitorimi i tij.**

Nga auditimi vlerësojmë se:

-Në pikën 1 nuk ka ndonjë udhëzim të veçantë ku punonjësve tu kërkohen vlerat etike, marrëdhëniet e sjelljes me eprorët, konfliktet e mundshme të interesave si dhe sjelljet me publikun, (***nuk ka të miratuar kod etike***).

-Në pikën II nuk pasqyrohet me përshkrim vlerësimi i 5 komponentëve të Sistemit të MFK-së, në ish Bashkin Fushë-Krujë .

**-Në pikën III (Gjetje dhe rekomandimet e Auditit të brendshëm dhe të jashtëm), ish Komuna Bubq, nuk ka patur strukturë të auditimit të brendshëm në strukturën organizative të saj.**

-Në pikën IV lidhur me (*Masat për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm*) nuk ka raportime.

-Në këtë Komunë nuk ka ndonjë udhëzim të shkruar lidhur me mënyrën e komunikimit brenda përbrenda njësisë (komunikim me shkrim elektronik, verbal).

-Sistemi i ITI-së nuk funksionon.

-Nuk disponohet një program trajnimesh për punonjësit e kësaj njësie, megjithëse një program i tillë do të ishte i nevojshëm dhe me impakt pozitiv.

Nga auditimi i ***përgjigjeve të Pyetësorit të vetëvlerësimit*** “Për Funksionimin e Sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për vitin 2014,2015,”dhe nga dokumentacioni i afruar, konstatohen mangësitë si më poshtë:

-Nuk janë përcaktuar Objektivat, Misioni dhe Vizioni Komunës dhe nuk informohen si duhet menaxherët dhe punonjësit e njësisë publike në lidhje me përmbajtjen e deklaratës së misionit, objektivave dhe të strategjisë. Gjithashtu plani strategjik i zhvillimit afat mesëm e afatgjatë, plani i veprimtimit afat shkurtër dhe objektivat nuk paraqiten..

**-Pyetësi nuk është plotësuar** në mënyrë të plotë në rubrika, mungojnë komentet dhe dokumentet bashkëlidhur tij, , pyetësi duhet të pasqyroj me vërtetësi dhe sinqeritet realitetin e vlerësimit të gjendjes së sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

-Përgjigjet e pyetësorit duhej dhënë në formë të plotë, duhej të *përshkruheshin sqarimet në kolonën “Komente, për secilën nga përgjigjet.*

-Në kolonën e vlerësimit me pikë për 5 seksionet ***vlerësimi i pikëve duhej vendosur në mënyrë korrekte, për të gjithë pyetësin.***

**-Mjedisi i Kontrollit,** nga ana e Komunës nuk është përfshirë në rregulloren e brendshme të Komunës të miratuar në Këshillin e Komunës.

**-Vetëvlerësimi nuk janë plotësuar sipas referimeve pyetjeve dhe komenteve si dhe dokumentacionit përkatës.**

**-Menaxhimi i Riskut,** nuk janë hartuar nga ana e Titullarit të Komunës dhe as nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë identifikimin e riskut.

**-Informimi dhe komunikimi merret nëpërmjet takimeve ditore dhe planeve mujore për secilin sektor.**

**-Monitorimi,** ky aspekt i menaxhimit financiar nuk kuptohet mirë dhe nuk funksionon si duhet..

Me gjendjen e paraqitur më sipër nuk jepet një vlerësim mesatar për 5 komponentët, çka do të thotë se aspektet e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, kuptohen pjesërisht dhe nuk funksionojnë në të gjitha hallkat e Komunës dhe se Titullari i Komunës duhet të shikojë mundësinë për të bërë programet e mësipërme.

-Mungesa e plotësimit tërësor dhe pasaktësitë në plotësimin e këtij pyetësori vjen nga mos shfrytëzimi i broshurës dhe i udhëzimeve përkatëse, ku përshkruhen konceptet kryesore të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, pra nga mos zbatimi i udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 1615, datë 12.02.2010 në procesin e plotësimit të këtij pyetësori.

***Formulimi, implementimi dhe monitorimi i vlerave të njësisë dhe i kodit të etikës.***

Nga auditim konstatohet se ky komponent vlerësohet si jo i përmbushur, pasi ***është*** miratuar Rregullorja Brendshme e Komunës, por ***nuk është*** hartuar dhe miratuar Kodi Etik për Institucionin dhe strukturat në veçanti, në përputhje me nenin 20, “Mjedisi i kontrollit”, të ligjit” nr. 10296, datë 8.7.2010.

***-Mbikëqyrja e vendimeve dhe veprimeve të menaxherëve.***

Nga auditimi u konstatua se nuk është realizuar mbikëqyrja e vendimeve dhe veprimeve të menaxherëve.

***-Realizimi i sistemit për marrjen e masave korrektuese dhe raportimin e rezultateve.***

Nga auditimi u konstatua se pohohet realizimi i sistemit për marrjen e masave korrektuese dhe raportimin e rezultateve në ish Komunën Thuman, por nuk ka dokumentacione lidhur me pasqyrimin e këtij komponenti të MFK.

***Për mos zbatimin e kërkesave sipas nenit 29, të ligjit nr. 10296, datë, 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ngarkohet me përgjegjësi ish titullari i Komunës Bubq dhe si punonjësi autorizues.***

NJSH-ja Nikël, sot egziston si Njësi Administrative”.

**Nga verifikimi dokumentacionit që disponon ky subjekt rezultoi që:**

-Janë dërguarë në Ministrinë e Financës, Deklarata për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm si dhe pyetsorin e vetëvlerësimit për vitin 2014-2015.

-Nuk ka funksionuar ***plani për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe metodologjia për zbatimin e tij.***

-Nuk janë ngritur nga Kryetari i Komunës, personi Autorizues ***Grupet e Menaxhimit Strategjik (GMS)*** dhe nuk ka miratuar kalendarin e punës për programin buxhetor afatmesëm.

***b.Organizimi i procesit. Hartimi i deklaratës së vizionit dhe misionit si dhe i objektivave themelore të aktivitetit. Plani strategjik, miratimi dhe monitorimi i tij.***

Nga auditimi vlerësojmë se:

-Në pikën 1 nuk ka ndonjë udhëzim të veçantë ku punonjësve tu kërkohen vlerat etike, marrëdhëniet e sjelljes me eprorët, konfliktet e mundshme të interesave si dhe sjelljet me publikun, ***(nuk ka të miratuar kod etike).***

-Në pikën II nuk pasqyrohet me përshkrim vlerësimi i 5 komponentëve të Sistemit të MFK-së, në ish Bashkin Fushë-Krujë.

***-Në pikën III (Gjetje dhe rekomandimet e Auditit të brendshëm dhe të jashtëm), ish Komuna Nikël, nuk ka patur strukturë të auditimit të brendshëm në strukturën organizative të saj.***

-Në pikën IV lidhur me ***(Masat për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm)*** nuk ka raportime.

-Në këtë Komunë nuk ka ndonjë udhëzim të shkruar lidhur me mënyrën e komunikimit brenda përbrenda njësisë (komunikim me shkrim elektronik, verbal).

-Sistemi i ITI-së nuk funksionon.

-Nuk disponohet një program trajnimesh për punonjësit e kësaj njësie, megjithëse një program i tillë do të ishte i nevojshëm dhe me impakt pozitiv.

Nga auditimi i *përgjigjeve të Pyetësorit të vetëvlerësimit* “Për Funkcionimin e Sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për vitin 2014-2015,” dhe nga dokumentacioni i afruar, konstatohen mangësitë si më poshtë:

-Nuk janë përcaktuar Objektivat, Misioni dhe Vizioni Komunës dhe nuk informohen si duhet menaxherët dhe punonjësit e njësisë publike në lidhje me përmbajtjen e deklaratës së misionit, objektivave dhe të strategjisë. Gjithashtu plani strategjik i zhvillimit afat mesëm e afatgjatë, plani i veprimit afat shkurtër dhe objektivat nuk paraqiten..

-*Pyetësi nuk është plotësuar* në mënyrë të plotë në rubrika, mungojnë komentet dhe dokumentet bashkëlidhur tij, pyetësi duhet të pasqyroj me vërtetësi dhe sinqeritet realitetin e vlerësimit të gjendjes së sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

-Përgjigjet e pyetësorit duhej dhënë në formë të plotë, duhej të *përshkruheshin sqarimet në kolonën “Komente*, për secilën nga përgjigjet.

-Në kolonën e vlerësimit me pikë për 5 seksionet *vlerësimi i pikëve duhej vendosur në mënyrë korrekte , për të gjithë pyetësin.*

-*Mjedisi i Kontrollit*, nga ana e Komunës nuk është përfshirë në rregulloren e brendshme të Komunës të miratuar në Këshillin e Komunës.

-*Vetëvlerësimi nuk janë plotësuar sipas referimeve pyetjeve dhe komenteve si dhe dokumentacionit përkatës.*

-*Menaxhimi i Riskut*, nuk janë hartuar nga ana e Titullarit të Komunës dhe as nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë identifikimin e riskut.

-*Informimi dhe komunikimi merret nëpërmjet takimeve ditore dhe planeve mujore për secilin sektor.*

-*Monitorimi*, ky aspekt i menaxhimit financiar nuk kuptohet mirë dhe nuk funksionon si duhet.

Me gjendjen e paraqitur më sipër nuk jepet një vlerësim mesatar për 5 komponentët, çka do të thotë se aspektet e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, kuptohen pjesërisht dhe nuk funksionojnë në të gjitha hallkat e Komunës dhe se Titullari i Komunës duhet të shikojë mundësinë për të bërë programet e mësipërme.

Mungesa e plotësimit tërësor dhe pasaktësitë në plotësimin e këtij pyetësi vjen nga mos shfrytëzimi i broshurës dhe i udhëzimeve përkatëse, ku përshkruhen konceptet kryesore të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, pra nga mos zbatimi i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 1615, datë 12.02.2010 në procesin e plotësimit të këtij pyetësi.

***Formulimi, implementimi dhe monitorimi i vlerave të njësisë dhe i kodit të etikës.***

Nga auditim konstatohet se ky komponent vlerësohet si jo i përmbushur, pasi *është* miratuar Rregullorja Brendshme e Komunës, por *nuk është* hartuar dhe miratuar Kodi Etik për Institucionin dhe strukturat në veçanti, në përputhje me nenin 20, “Mjedisi i kontrollit”, të ligjit” nr. 10296, datë 08.7.2010.

***Mbikëqyrja e vendimeve dhe veprimeve të menaxherëve.***

Nga auditimi u konstatua se nuk është realizuar mbikëqyrja e vendimeve dhe veprimeve të menaxherëve.

***Realizimi i sistemit për marrjen e masave korrektuese dhe raportimin e rezultateve.***

Nga auditimi u konstatua se pohohet realizimi i sistemit për marrjen e masave korrektuese dhe raportimin e rezultateve në ish Komunën Thuman, por nuk ka dokumentacione lidhur me pasqyrimin e këtij komponenti të MF

***Për mos zbatimin e kërkesave sipas nenit 29 të ligjit nr. 10296 datë, 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ngarkohet me përgjegjësi ish titullari i Komunës Nikël z.Rr.R. dhe si punonjësi autorizues.***

***NJSH-ja Cudhi*, sot egzistojnë si Njësi Administrative”.**

***Nga verifikimi rezultoi që:***

-Janë dërguarë në Ministrinë e Financës, Deklarata për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm si dhe pyetësin e vetëvlerësimit për vitin 2014-2015.

-Nuk ka funksionuar *plani për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe metodologjia për zbatimin e tij.*

-Nuk janë ngritur nga Kryetari i Komunës , personi Autorizues **Grupet e Menaxhimit Strategjik (GMS)** dhe nuk ka miratuar kalendarin e punës për programin buxhetor afatmesëm.

**b.Organizimi i procesit. Hartimi i deklaratës së vizionit dhe misionit si dhe i objektivave themelore të aktivitetit. Plani strategjik, miratimi dhe monitorimi i tij.**

Nga auditimi vlerësojmë se:

-Në pikën 1 nuk ka ndonjë udhëzim të veçantë ku punonjësve tu kërkohen vlerat etike, marrëdhëniet e sjelljes me eprorët, konfliktet e mundshme të interesave si dhe sjelljet me publikun, (***nuk ka të miratuar kod etike***).

-Në pikën II nuk pasqyrohet me përshkrim vlerësimi i 5 komponentëve të Sistemit të MFK-së, në ish Bashkin Fushë-Krujë.

**-Në pikën III (Gjetje dhe rekomandimet e Auditit të brendshëm dhe të jashtëm), ish Komuna Cudhi, nuk ka patur strukturë të auditimit të brendshëm në strukturën organizative të saj.**

-Në pikën IV lidhur me (*Masat për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm*) nuk ka raportime.

-Në këtë Komunë nuk ka ndonjë udhëzim të shkruar lidhur me mënyrën e komunikimit brenda përbrenda njësisë (komunikim me shkrim elektronik, verbal).

-Sistemi i ITI-së nuk funksionon.

-Nuk disponohet një program trajnimesh për punonjësit e kësaj njësie, megjithëse një program i tillë do të ishte i nevojshëm dhe me impakt pozitiv.

Nga auditimi i ***përgjigjeve të Pyetësorit të vetëvlerësimit*** “Për Funksionimin e Sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për vitin 2014-2015,” dhe nga dokumentacioni i afruar, konstatohen mangësitë si më poshtë:

-Nuk janë përcaktuar Objektivat, Misioni dhe Vizioni Komunës dhe nuk informohen si duhet menaxherët dhe punonjësit e njësisë publike në lidhje me përmbajtjen e deklaratës së misionit, objektivave dhe të strategjisë. Gjithashtu plani strategjik i zhvillimit afat mesëm e afatgjatë, plani i veprimtimit afat shkurtër dhe objektivat nuk paraqiten.

**-Pyetësi nuk është plotësuar** në mënyrë të plotë në rubrika, mungojnë komentet dhe dokumentet bashkëlidhur tij, pyetësi duhet të pasqyroj me vërtetësi dhe sinqeritet realitetin e vlerësimit të gjendjes së sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

-Përgjigjet e pyetësorit duhej dhënë në formë të plotë, duhej të ***përshkruheshin sqarimet në kolonën “Komente***, për secilën nga përgjigjet.

-Në kolonën e vlerësimit me pikë për 5 seksionet ***vlerësimi i pikëve duhej vendosur në mënyrë korrekte , për të gjithë pyetësin.***

**-Mjedisi i Kontrollit**, nga ana e Komunës nuk është përfshirë në rregulloren e brendshme të Komunës të miratuar në Këshillin e Komunës.

**-Vetëvlerësimi nuk janë plotësuar sipas referimeve pyetjeve dhe komenteve si dhe dokumentacionit përkatës.**

**-Menaxhimi i Riskut**, nuk janë hartuar nga ana e Titullarit të Komunës dhe as nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë identifikimin e riskut.

**-Informimi dhe komunikimi merret nëpërmjet takimeve ditore dhe planeve mujore për secilin sektor.**

**-Monitorimi**, ky aspekt i menaxhimit financiar nuk kuptohet mirë dhe nuk funksionon si duhet.

Me gjendjen e paraqitur më sipër nuk jepet një vlerësim mesatar për 5 komponentët, çka do të thotë se aspektet e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, kuptohen pjesërisht dhe nuk funksionojnë në të gjitha hallkat e Komunës dhe se Titullari i Komunës duhet të shikojë mundësinë për të bërë programet e mësipërme.

Mungesa e plotësimit tërësor dhe pasaktësitë në plotësimin e këtij pyetësori vjen nga mos shfrytëzimi i broshurës dhe i udhëzimeve përkatëse, ku përshkruhen konceptet kryesore të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, pra nga mos zbatimi i udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 1615, datë 12.02.2010 në procesin e plotësimit të këtij pyetësori.

**Formulimi, implementimi dhe monitorimi i vlerave të njësisë dhe i kodit të etikës.**

Nga auditim konstatohet se ky komponent vlerësohet si jo i përmbushur, pasi **është** miratuar Rregullorja Brendshme e Komunës, por **nuk është** hartuar dhe miratuar Kodi Etik për Institucionin dhe strukturat në veçanti, në përputhje me nenin 20, “Mjedisi i kontrollit”, të ligjit” nr. 10296, datë 8.7.2010.

**-Mbikëqyrja e vendimeve dhe veprimeve të menaxherëve.**

Nga auditimi u konstatua se nuk është realizuar mbikëqyrja e vendimeve dhe veprimeve të menaxherëve.

**-Realizimi i sistemit për marrjen e masave korrektuese dhe raportimin e rezultateve.**

Nga auditimi u konstatua se pohohet realizimi i sistemit për marrjen e masave korrektuese dhe raportimin e rezultateve në ish Komunën Cudhi, por nuk ka dokumentacione lidhur me pasqyrimin e këtij komponenti të MFK.

**Për mos zbatimin e kërkesave sipas nenit 29, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ngarkohet me përgjegjësi ish titullari i Komunës Cudhi z.Xh.P. dhe si punonjësi autorizues.**

**Titulli i Gjetjes:** Nuk ka funksionuar plani për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe metodologjia për zbatimin e tij.

**Situata:** Nuk është hartuar plani strategjik, nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut, nuk është hartuar plani i veprimeve për arritjen e objektivave, nuk është ngritur grupi i menaxhimit strategjik ku në krye të jenë drejtuesit e NJSH-ve. Veprimi dhe mosveprimi është kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

**Kriteri:** Ka shumë mangësi në mos implementimin e nenit 29, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

**Ndikimi/Efektit:** Pasojat lidhen me mos mbikëqyrjen e vendimeve dhe veprimeve të menaxherëve, për pasojë krijohen mundësi me të shumta të shkeljeve dhe abuzimeve financiare.

**Shkaku:** Një nga faktorët kryesorë që ka ndikuar në mos hartimit të plani strategjik, lëvizjet e punonjësve nga ristrukturimi i Bashkisë dhe kualifikimi i pa mjaftueshëm i punonjësve drejtues të sektorëve të administratës.

**Rëndësia:** I mesëm.

**Rekomandime:** Bashkisë Krujë, të marrë masa për implementimin e kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” mbeshtetur dhe në gjëndjen e konstatuar gjatë auditimit.

## **II. MBI ZBATIMIN E BUXHETIT TË ISH-BASHKISË FUSHË KRUIJË DHE ISH KOMUNAVE.**

–Planifikimi i buxhetit, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të njërive vendore, i kritereve në çeljen e buxhetit, detajimin i planit fillestar, kompetencat, domosdoshmëria dhe argumentimi i transferimeve të fondeve buxhetore gjatë vitit ushtrimor dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore. Realizimit i të ardhurave të programuara dhe analiza e tyre.

Planifikimi i buxhetit të vitit ushtrimor në NJSH-të, ka filluar me analizën e realizimit të buxhetit të vitit paraardhës i cili i është paraqitur këshillit të NJSH-ve në formën e projekt-buxhetit. Projekt-buxhetit shoqërohej me relacion e pregaditur nga grupi i punës i ngritur nga Titullari Miratimi i buxheteve të NJSH-ve sipas viteve, janë kryer nga Këshillat e Njësive Vendore (NJSH-ve) sipas viteve që pasqyrohen si më poshtë:

EMERTIMI	Viti 2014		Viti 2015		Viti 2016
	Vendim nr/date	Objekti i Vendimit	Vendim nr/date	Objekti i Vendimit	Vendim nr/date
Bashkia Kruje	9,dt.13.03.2014	Miratim buxheti	12,dt.23.03.2015	Miratim buxheti	7,dt.17.02.2016
Ish Bashkia Fushe-Kruje	56,dt.19.02.2014	Miratim buxheti	4,dt.02.02.2015	Miratim buxheti	
Komuna Thumane	7,dt.27.03.2014	Miratim buxheti	7,dt.20.02.2015	Miratim buxheti	
Komuna Nikel	7,dt.26.03.2014	Miratim buxheti	7,dt.26.02.2015	Miratim buxheti	
Komuna Bubq	9,dt.18.03.2014	Miratim buxheti	13,dt.11.03.2015	Miratim buxheti	
Komuna Cudhi	14,dt.25.03.2014	Miratim buxheti	10,dt.17.03.2015	Miratim buxheti	
<b>Totali</b>	<b>6</b>		<b>6</b>		<b>1</b>

1.Nga auditimi i buxhetit të Bashkisë Krujë, konstatohet se miratimi i tyre është bërë me shumë vonesë: Në Bashkinë Krujë në vitit 2014, buxheti është miratuar me Vendimin e Këshillit nr. 9, datë 13.3.2014, në vitit 2015 është miratuar me Vendimin nr. 7, datë 17.02.2016, duke shkelur afate e përcaktuara në nenin 32 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 ku shprehet se: Këshilli i qeverisjes vendore, brenda datës 31 Dhjetor, miraton buxhetin vendor në bazë të vlerësimit të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor. Në këto kushte miratimi me vonesë e buxhetit, ka sjellë vonesa dhe në vendimmarrje, që duhej të kryhet në kohë si për përcaktimin e numrin e punonjësve,pagat, strukturën organizative të Bashkisë shpenzimeve ,investimeve dhe të ardhurave.

Miratimi i buxheteve nga këshilli i Bashkisë janë kryer me vonës në muajt Mars të viteve ushtrimore 2014-2015-2016, duke mos treguar arsyet e kësaj vonese dhe duke mos parashikuar vështersit që sjedhin këto vonesa në implementimin e tij me eficence.

2.Nga auditimi dokumentacioneve, protokolleve të mbledhjeve të Këshillave NJSH-ve për miratimin e buxhetit ndër vite, konstatohet se janë miratuar buxhetet e viteve 2014-2016 nga këshillat e Njësive vendore, por në këto Këshilla, nuk janë pasqyruar paraqitja formale e Projekt-Vendimeve dhe relacionet përkatëse, nuk janë evidentuar analiza apo propozime të ndryshme lidhur me Projekt buxhetin nga ana e këshilltareve.

–Në procesin e miratimit buxhetit nga Këshilli i Bashkisë nuk konstatohen diskutime, debate apo sqarime lidhur me parashikim e treguesve ekonomik financiar, me perjashtim të Bashkisë Fushë-Krujë e cila i ka pasqyruar diskutimet në protokollin e mbledhje të Këshillit për vitin 2014-2015.

–Planifikimi i buxhetit të vitit ushtrimore në NJSH-të ka filluar me analizën e realizimit të buxhetit të vitit paraardhës i cili shprehet në tabelat e realizimit të treguesve sindetik si më poshtë

–Nëpunësit zbatues i Bashkisë ***nuk i kanë paraqitur Nëpunësit të Parë Autorizues informacion mbi performancën e produkteve të buxhetit vjetorë brenda datës 28 të muajit pasardhës të çdo tremujore***, sipas detyrave të përcaktuar në pikën 256 të Udhëzimin Nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

3.Vlerësimi i situatës financiare të Bashkisë, mbi të dhënat e konsoliduar të ish Bashkive, faturat e pa likuiduara dhe vendimet gjyqësore të formës prerë regjistrimi i tyre në kontabilitet; (Si faturat e pa likuiduara dhe vendimet gjyqësore të paraqiten edhe ne forme tabelore).

–Raportimi nga Kryetar i Bashkisë në Këshillin Bashkiak, të gjendjes ekonomik-financiare, të paktën njëherë në 6 muaj, sipas nenit 44, të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, dhe për vitin 2016 e në vazhdim sipas nenit 64 të

ligjit nr. 30/2015 dhe ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; i cili ka shfuqizuar ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000.

Konstituimi i organeve të Bashkisë Krujë është realizuar në datë 30.7.2015, kur ka marrë detyrën kryetari i zgjedhur i Bashkisë Krujë, kur dhe kanë përfunduar aktivitetin ish Bashkitë e Komunat të cilat u shëndrruan në Njësi Administrative nën drejtimin e administratorëve të emeruar nga kryetari i Bashkisë.

Marëdhënjet e punës së personelit dhe gjithë punonjësve të ish komunave janë transferuar në bashkinë Krujë gjatë muajit gusht 2015 ku janë marë në dorëzim të gjitha dosjet e personelit nga njësitë administrative dhe administrohen nga Drejtoria e Burimeve Njerzore.

Deri në datën 30 shtator 2015 numri total i punonjësve të ish bashkive dhe komunave në plan ka qenë gjithsej 402 punonjës, ndarë në 69 Npc dhe 333 punonjës me kontratë sipas njërive si në tabelen bashkelidhur.

Në muajin Shtator 2015 Kryetari i Bashkisë me urdhër nr.71, datë 15.09.2015 ka miratuar Strukturën Organizative Provizore të Bashkisë dhe njërive administrative me 263 punonjës gjithsej, ndarë në 59 punonjës me statusin NPC dhe 204 punonjës me kontratë, me të cilën ka operuar Bashkia nga 1 tetori 2015 deri në 1 shkurt 2016.

Komisioni i ristrukturimit i ngritur me urdher nr. 81, datë 15.09.2015 studiojë dosjet e personelit dhe me procesverbalin nr.1916 datë 23.09.2015 ka evidentuar të gjithë punonjësit që kanë qenë në marrëdhënie pune me ish bashkitë dhe komunat të cilët u transferuan në bashkinë e madhe.

Komisioni ka shqyrtuar punonjësit që kishin fituar statusin e nëpunësit civil si dhe ka studiuar dosjet për të cilat nuk ishin shprehur njesite e burimeve njerzore të Komunave dhe ka deklaruar me status nëpunësi, gjithsej 74 nëpunës civil.

Gjatë periudhës së ristrukturimit, numri i punonjësve si plan në total u reduktua nga 402 vetë në 263 vetë, me 139 vetë më pak, nga të cilët 18 me statusin NPC, dhe 119 punonjës me kod pune, në fakt 136 punonjës të cilët janë trajtuar në pëputhje me kreun e IV-të të VKM nr.510 datë 10.06.2015 “Për transferimin e personelit dhe aktivav”. Me VKB nr. 81, datë 30.12.2015, numri maksimal i punonjësve nga data 1.02.2016 u rrit në 310 vetë, nga të cilët 96 me status NPC dhe 214 punonjës me kontratë, ndërsa me VKB nr.28 datë 31.05.2016, numri maksimal i punonjësve nga 1.06.2016 u rrit në 320 vetë, nga të cilët 108 NPC dhe 212 punonjës me kontratë. Me VKB nr.72, datë 06.01.2017, numri maksimal i punonjësve nga 1.02.2017 u rrit në 340 vetë, nga të cilët 107 NPC dhe 233 punonjës me kontratë ndërsa me VKB nr.99, datë 03.05.2017 numri maksimal i punonjësve nga 1.06.2017 u rrit në 350 vetë, nga të cilët 108 NPC dhe 242 punonjës me kontratë.

Aktualisht numri i punonjësve gjithsej si bashki është: plan 350 punonjës, 52 punonjës më pak se në vitin 2015, ndërsa në fakt 341 punonjës, ose 54 punonjës më pak se në vitin 2015.

**Tabela e Shpenzimeve për paga dhe sigurimeve shoqërore sipas NJSH-ve të Bahkisë Krujë.**

000/lekë

Nr.	NJSHA Fondet e Veta	Viti 2014		Viti 2015		Viti 2016	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Kruje	58,680	54,805	104,397	100,436	252,908	232,456
2	Fushe-Kruje	48,408	43,957	45,538	24809	0	0
3	Thumane	33,551	31,869	32,608	11,114	0	0
4	Nikel	24,906	20,193	23,224	12,683	0	0
5	Bubq	22,068	17754	22,587	9687	0	0
6	Cudhi	8,457	8280	9,326	3938	0	0
	<b>TOTALI</b>	<b>196,070</b>	<b>176,858</b>	<b>237,680</b>	<b>162,667</b>	<b>176,818</b>	<b>164,934</b>

Llogaritja e pagave te administrates është bërë sipas VKM Nr.586, datë 17.07.2013 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njesive te qeverisjes vendore per efekt page dhe caktimin e kufijve te pagave te punonjesv” si dhe mbeshteur ne ligjin nr. 160/2014, date 27.11.2014 “Per Buxhetin e vitit 2015”.

Siç konstatohet në tabelen e mesiperme fondi i pagave në vitin 2016 në krahasim me vitin 2015 ka pasur ndryshime si rezultat i numërit të punonjesve të shtuar në vitin 2016 në krahasim me vitin 2015.

**Tabela e numërit punonjesve që nuk përfshihen në strukturën e Bashkisë Krujë**

Nr.	NJSHA	Viti 2014		Viti 2015		Viti 2016	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Kruje	4	4	4	4	4	4
2	Fushe-Kruje	2	2	2	2	2	2
3	Thumane	2	2	2	2	2	2
4	Nikel	1	1	1	1	1	1
5	Bubq	1	1	1	1	1	1
6	Cudhi	1	1	1	1	1	1
	<b>TOTALI</b>	<b>11</b>	<b>11</b>	<b>11</b>	<b>11</b>	<b>11</b>	<b>11</b>

Në këtë tabel pasqyrohen punonjësit buxhetorë, për funksionet e deleguar siç janë: punonjësit e gjendjes civile, QKB-së, numëri i tyre nuk ka ndryshuar në vite, pasi ato janë planifikuar nga buxheti i shtetit.

**Tabela e Shpenzimeve për investime me fondet e veta në Bashkinë Krujë në vitet 2014-2016.**

Nr.	NJSHA Fondet e Veta	viti 2014		Viti 2015		Viti 2016	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Kruje	32,903	19,540	88,000	79,048	163,261	88,490
2	Fushe-Kruje	91,241	41,642	157364	108904	0	0
3	Thumane	4,786	4770	0	0	0	0
4	Nikel	51,645	12,133	2,965	8,450	0	0
5	Bubq	43,475	42,645	3,016	2,331	0	0
6	Cudhi	12,670	2,118	9,505	1,520	0	0
	<b>TOTALI</b>	<b>236,720</b>	<b>122,848</b>	<b>260,850</b>	<b>200,253</b>	<b>163,261</b>	<b>88,490</b>

Siç konstatohet në tabelën e mësipërme buxheti për insvesimet me fondet e veta në Bashkinë e Krujës, ka ardhur duke u ulur nga viti në vit si rezultat e planifikimit më të ulët të ardhurave në këto njësi, **të ardhurat e planifikuar në vitin 2014 kanë qenë 304,786 mijë lekë**, ndërsa në vitin 2016 në **vlerën 250,000 mijë/lekë**. Në vitin 2016 janë tejkualuar të ardhurat e planifikuar me vlerën 33,173 mijë lekë. Kjo tregon për planifikim me të ulët se mundësitë e realizimit të ardhurave.

Nga analiza e bërë lidhur me krahasimin e shpenzimet operative të kryera konstatohet se me gjithë tejkalimi i të ardhurave në vitin 2016 nuk janë kryer me shumë investime por shpenzime operative, të cilat janë realizuar në vitin 2016 rreth 86% me shumë se në 2014.

**Tabela e investime në bashkinë Krujë me fondet buxhetore sipas viteve 2014-2016.**

Nr.	NJSHA FZHR dhe Buxhetore	viti 2014		Viti 2015		Viti 2016	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Kruje	87,115	87,111	62563	60,388	230,236	221,689
2	Fushe-Kruje	177074	114070	81329	81329	0	0
3	Thumane	0	0	0	0	0	0
4	Nikel	14812	14800	13139	13139	0	0
5	Bubq	42165	40526	0	0	0	0
6	Cudhi	0	0	0	0	0	0
	<b>TOTALI</b>	<b>321,166</b>	<b>256,507</b>	<b>15,7031</b>	<b>154,856</b>	<b>230,236</b>	<b>1,689</b>



Nga tabela e mesiperme konstatohet se fondet buxhetore shtetore nga viti 2014 në krahasim me vitin 2016 janë pakësuar me vlerën 90,930 mijë lekë.

### ***Shpenzimet për mbrojtjen sociale në Bashkinë Krujë.***

Ndihma ekonomike është përballuar nga fondet buxhetore të planifikuara në fillim të çdo viti. Bashkia Krujë ka respektuar destinacionin e përcaktuar nga Ministria përgjegjëse.

***Tabela e numërit të familjeve që kanë përfituar ndihmën ekonomike për vitet 2014-2016 në Bashkinë Krujë dhe NJSH-të***

Nr	NJSHA	Viti 2014		Viti 2015		Viti 2016	
		Nr	Fond	Nr	Fond	Nr	Fond
1	Kruje	79	6,960,160	73	3,633,500	74	3,607,060
2	Fushe-Kruje	169	10,035,815	145	9,482,140	219	11,116,660
3	Thumane	24	1,256,420	31	2,189,340	63	3,161,040
4	Nikel	33	2,609,830	70	4,646,683	77	4,955,580
5	Bubq	1	108,000	1	108,000	6	220,140
6	Cudhi	112	6,452,420	106	8,127,500	124	8,287,380
	<b>TOTALI</b>	<b>418</b>	<b>27,422,645</b>	<b>426</b>	<b>28,187,163</b>	<b>563</b>	<b>31,347,860</b>

Nga të dhënat në tabelën e mesipërme konstatohet se numëri i familjeve që përfitojnë ndihme ekonomike në vitin 2014 para riorganizimit të pushtetit vendor ishte 418 familje dhe në vitin 2016 është rritur është me 563 familje.

Arsyeja e shtimit të numërit familjeve që përfitojnë ndihme ekonomike prej 145 familjeve në vitin 2016, në krahasim me vitin 2014 krahas ***faktorit ekonomik është dhe lehtësimi drastik i procedurave të aplikimit për ndihmë ekonomike.***

Gjatë vitit 2016 Drejtoria e Sherbimit Social në Bashkinë Krujë është kontrolluar nga Drejtorija Rajonale e Sherbimit Social Durres sipas programit Nr.1218, datë 29.09.2016. Ky grup ka hartuar Akt-Kontrollin me datë 25.12.2016, i cili nuk ka konstatuar shkelje nga verifikimi i dosjeve të perfituesve si dhe gjendjes familjare.

Në bashkinë Krujë funksionojnë qendrat rezidenciale NJSH-së Fushë dhe Bubq ku trajtohen rreth 146 femijë si persona me aftësi të kufizuar, femijë të braktisur etj. Shpenzimet për akomodimin e tyre behen nga shoqatat bamirëse, ambientet janë siguruar nga pushteti vendor.

### ***Shpenzimet për përkujdesjen shoqërore***

Shpenzimet për përkujdesjen shoqërore, financohen nga buxheti i shtetit në formën e fondeve të kushtëzuara, bashkia dhe NJSH-të.

***Tabela e personave me aftësi të kufizuar në Bashkinë Krujë për vitet 2014-2016***

Nr	NJSHA	Viti 2014		Viti 2015		Viti 2016	
		Nr	Fond	Nr	Fond	Nr	Fond
1	Kruje	405	64,010,27	350	51,955,38	346	52,887,676
2	Fushe-Kruje	512	77,241,47	516	70,243,43	518	74,297,015
3	Thumane	342	49,720,62	301	43,153,50	328	45,832,331
4	Nikel	218	29,898,80	204	26,648,25	199	27,749,320
5	Bubq	188	28,790,52	194	26,846,55	184	27,647,755
6	Cudhi	104	15,350,10	104	15,211,21	111	15,710,630
	<b>TOTALI</b>	<b>1,769</b>	<b>265,011,799</b>	<b>1,669</b>	<b>234,058,333</b>	<b>1,686</b>	<b>244,124,727</b>

**Tabela e invalideve të punës në bashkinë Krujë për vitet 2014-2016**

Nr	NJSHA	Viti 2014		Viti 2015		Viti 2016	
		Nr	Fond	Nr	Fond	Nr	Fond
1	Kruje	592	21,944,800	605	22,795,700	598	22,604,100
2	Fushe-Kruje	401	15,011,300	433	16,256,100	443	16,534,800
3	Thumane	239	17,267,200	262	9,951,300	271	100,20,800
4	Nikel	96	3,691,700	103	3,941,400	105	4,004,700
5	Bubq	111	4,116,900	111	4,339,200	113	4,514,100
6	Cudhi	38	1,548,300	40	1,621,300	41	1,629,300
	<b>TOTALI</b>	<b>1477</b>	<b>63,580,200</b>	<b>1554</b>	<b>58,905,000</b>	<b>1571</b>	<b>59,307,800</b>

**Nga tabela e mësipërme konstatohet se numëri i personave me aftësi të kufizuar ka ardhur duke u paksuar në 83 persona si rezultat i kontrollit të specializuar të kryer nga persona të specializuar si mjekë.**

Gjatë vitit 2014 është ushtruar një kontrolli speciaslizuar me pjesmarrje nga Ministria e Shendetësisë dhe Ministrria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë mbështetur në Urdhërin e përbashkët nr.78, datë 11.04.2014.

Nga 284 dosje të kontrolluara, 31 përfitues nga statusi i para-tetraplegjiku, 78 përfitues nga statusi i verbërisë dhe **175 përfitues të paaftësisë janë konstatuar shkelje si në plotësimin e dosjeve** nga KMCAP Rajonale nga ku janë lenë detyra për rivlersim në KMCAP epror të dosjeve si dhe të vendosen saktë emerat e antarëve të antarëve KMCAP-i Rajonal.

Detyrat e lena nga kontrolli janë zbatuar me rigorizitet dhe si rrjedhojë janë pakësuar përfituesit me 83 invalid.

**2. Vlerësimi i situatës financiare të Bashkisë, mbi të dhënat e konsoliduar të ish- bashkive, faturat e pa likuiduara dhe vendimet gjyqësore të formës prerë regjistrimi i tyre në kontabilitet;**

**a. Shlyerjes se detyrimeve financiare ligjore te mbartura nga viti i mëparshëm por te pa shlyera për shkaqe ligjore duke i analizuar sipas llojit te shpenzimeve dhe njësive shpenzuese.**

**4. Në zbatim të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ”Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe sipas udhëzimit nr. 1, datë 4.6.2014 është kryer ekzekutimi i vendimeve gjyqësore nga Bashkia Kruje. Fondet buxhetore për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore janë akorduar në ligjin vjetor të buxhetit pasardhës për shlyerjen e detyrimeve të vitit paraardhës (duke respektuar radhën e paraqitjes në njësinë shpenzuese).**

**Pasqyra e detyrimeve sipas viteve 2014,2015 dhe 2016**

Nr.	Llogaria detyrim. Aktiv	Llogaria Detyrim. Pasiv	Peshkrimi	Gjendja m 31.12.201	Gjendja me 07.07.2015	Gjendja me 31.12.2015	Gjendja me 31.12.2016
1	468		Debitor te ndryshem	153,975,590	164,895,549	221,838,008	201,220,723
		434.1	Operac.shtetin kreditor	153975590	164895549	221838008	201,220,723
	434.2		Operac.shtetin debitor	153298596	128237812	169182290	118125375
		421	Pagat dhjetor	15485810	4797500	17473453	17048597
		431	T.Page dhjetor	457289	0	486810	845027
		435	Sig.shoq. dhjetor	4627335	785150	4449653	5000753
		436	Sig.shend. dhjetor	625961	88984	598628	689562
		467	Kreditor te ndryshem	64481145	0	60239098	118125375
		401	Fatura sherb. dhjetor	67,621,056	100,06,5017	85,934,648	4,653,765

**Llogaria 468 – Debitorë të ndryshëm**, që përfaqëson shuma e *detyrimeve* për personat ndaj buxhetit të shtetit të përbëra nga detyrime të pa arkëtuara për taksat dhe tarifatat vendore, dhe zhdëmtime të pa arkëtuara.

Në bilancin e vitit 2014, llogaria 468, “Debitor të ndryshëm”, vlera është **153,975,590** lekë ndërsa sipas akt- akordimeve të kryera detyrimi është 153,298,596 lekë me diferencë -676,994 lekë që nuk është kontabilizuar dhe pasqyruar në bilancin e vitit 2014.

Nga auditimi konstatohet se është kryer kontabilizimi i detyrimeve nga ana e sektorit financiar që kanë subjektet ndaj detyrimeve tatimore.

Në bilancin e vitit 2014, llogaria 468, “Debitor të ndryshëm”, vlera është 153,975,590 lekë ndërsa sipas akt rakordimeve të kryera detyrimi është 153,975,590 lekë, pra nuk ka diferencë.

Në bilancin e vitit 2015, llogaria 468, “Debitor të ndryshëm”, vlera është 221,838,008 lekë ndërsa sipas akt rakordimeve të kryera detyrimi është 221,838,008 lekë, nuk ka diferencë në lekë, është kontabilizuar dhe pasqyruar në bilancin e vitit 2015 detyrimi i subjekteve ndaj Bashkisë Krujë.

Në bilancin e vitit 2016, llogaria 468, “Debitor të ndryshëm”, vlera është **201,220,723** lekë. Sipas akt rakordimeve të kryera rezulton se është po e njëta vlerë prej **201,220,723** lekë. Nga të dhënat e mësipërme konstatohet se janë kontabilizuar dhe pasqyruar në bilancin e vitit 2014-2015 e 2016 detyrimi i subjekteve privatë.

**Llogaria 434.1. -Operacione me shtetin kreditor**, që përfaqëson gjendjen kreditore në bilanc me kundërparti debitorin e llogarisë **468, por meqenëse llog.468 pasqyron saktë kreditor edhe kjo llogari nuk pasqyron saktë ashtu si kundërpartia e saj.**

**Llogaria 434.2. -Operacione me shtetin debitor të vitit 2014**, Përfaqëson gjendjen debitore në pasqyrat financiare me kundërparti kreditorin e llogarive përkatëse: llogarive 421,431,435,436,467 në vlerë 153,298,596 lekë, kjo vlerë rakordon pasi shuma e vlerave të llogave në pasqyrat financiare për vitin 2014 është në 153,298,596 lekë, nuk ka diferencë.

**Llogaria 421. -Pësoneli e llogari të lidhura me to**, që pasqyron shumën e detyrimit të konstatuar për pagat e muajit Dhjetor të vitit 2013 që është vlerën 15485810 lekë, kjo vlerë që ka ardhur duke u rritur nga krahasimi i viteve 2014-2015 që ka qënë 1,562,787 lekë, pasqyron transferimin e punonjësve të funksioneve të deleguara si Arsim, Bordi i Kullimit, Pyjorja, Sektori Zjarrfikseve e tj.

**Llogaria 431. -Shteti Tatim Taksa**, që pasqyron shumën e detyrimit të konstatuar për tatim page për muajin Dhjetor 2013-2015. Të dhënat e pasqyrave financiare për vitet e audituara janë reale dhe të sakta.

**Llogaria 435. -Sigurime Shoqërore**, që pasqyron shumën e detyrimit të konstatuar për sig.shoq & suplementare për muajin Dhjetor 2015-2015. Të dhënat e pasqyrave financiare për vitet e audituara janë reale dhe të sakta.

**Llogaria 436. -Sigurime Shëndetësore**, që pasqyron shumën detyrimit të konstatuar për sig.shëndetësore për muajin Dhjetor 2013-2015. Të dhënat e pasqyrave financiare për vitet e audituara janë reale dhe të sakta.

**Llogaria 467. -Kreditore të ndryshëm**, që pasqyron shumën detyrimit që ka Institucioni ndaj të tretëve për shërbimet si energji, fatura të pa likuiduara punimesh dhe blerje mallrash. etj. të muajit Dhjetorë 2013-2015, si dhe detyrimet për vendimet gjyqësore të formës së prerë për personat e liruar nga detyra dhe të pa likuidura deri me datë 31 Dhjetor 2013-2015.

Vendimet gjyqësore të likuiduara, janë për personat e larguar nga puna nga NJSH-të, para procesit të riorganizimit të pushtetit vendorë në vitin 2015.

***Tabela e likuidimeve gjyqësore të punonjësve për largim nga puna në bashkinë Krujë***

Nr	Emri i personit perfitues	Vendimi	Data paraqitjes vendimit për ekzekutim	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2016
				Detyrimet në vitin 2015	Likuiduar	Mbeten likuidim
1	R.F.	Largim nga puna	22.01.2016	719,100	719100	0
2	R.LI.	Largim nga puna		717,500	358,750	358,750

3	L.T.	Largim nga puna		1,247,341	1,247,341	0
4	A.Sh.	Largim nga puna	20.06.2016	4,974,115	4,974,115	0
5	A.N.	Largim nga puna		546,000	0	546000
6	M.K.	Largim nga puna	24.05.2017	406,600	406,600	0
7	P.P.	Largim nga puna		79082	79,082	0
8	Y.K.	Largim nga puna		1,757,538	0	1,757,538
9	B.G.	Largim nga puna	01.07.2016	954,000	500,000	454,000
10	V.N.	Largim nga puna	10.03.2017	391,180	391,180	0
<b>Totali</b>			<b>Detyrimi</b>	<b>11,792,456</b>	<b>8,676,168</b>	<b>3,116,288</b>

Nga auditimi konstatohet se: Pagesa e vendimeve gjyqësore të likuiduar është bërë për punonjësit e larguar nga puna në NJSH-të para riorganizimit pushtetit vendor.

Urdhrat e ekzekutimit nga Zyrat përmbarimore janë paraqitur në vitin 2015 dhe 2016, si detyrime të trashëguara nga NJSh-të sipas viteve më poshtë vijon.

**Viti 2008:** Në vendim gjyqësor me vlere 79,082 lekë.

R.F. -trashëguar si detyrim nga ish Komuna Thumane për vitin 2014.

R.Ll. -trashëguar si detyrim nga ish Komuna Thumane për vitin 2012.

L.T. -trashëguar si detyrim nga ish Komuna Thumane për vitin 2014.

M.K. -trashëguar si detyrim nga ish Komuna Thumane për vitin 2014.

A.Sh. -trashëguar si detyrim nga ish Komuna Bubq për vitin 2011.

P.P. -trashëguar si detyrim nga ish Komuna Bubq për vitin 2008.

V.N. -trashëguar si detyrim nga ish Komuna Nikel për vitin 2015.

A.N. -trashëguar si detyrim nga ish Bashkia Kruje për vitin 2012.

B.Go. -trashëguar si detyrim nga ish Bashkia Kruje për vitin 2010.

**Viti 2010:** Nje vendim gjyqësor ne vlere 954,000 lekë, likuiduar pjesërisht.

**Viti 2011:** Nje vendim gjyqësor ne vlere 4,974,115 lekë, likuiduar.

**Viti 2012:** Dy vendime gjyqësore ne vlere 1,263,500 lekë, likuiduar

**Viti 2014:** Tre vendime gjyqësore me vlere 1,843,200 lekë, pa likuiduar

Viti 2015 (V.N. vendim i dates 01.7.2015 dhe Y.K. dhjetor 2015, që ndodhet ne Gjykatën e Lartë) Dy vendime gjyqësore me vlere: 2,148,718 lekë.

Për vitin 2013, detyrimet që rrjedhin nga vendimet e gjykatës së formës prerë që janë dhënë në favor të punonjësve që janë larguar nga puna është në vlerën 9,205,461 lekë, për vitin 2014 detyrimi ka qenë në vlerën 202,921, për vitin 2015 detyrimi ka qenë në vlerën 1,775,953 lekë. Kjo vlerë rakordon me vlerën e pasqyruar në pasqyrat financiare të deklaruara. Të dhënat e pasqyrave financiare për vitet e audituara janë reale dhe të sakta.

Siq konstatohet në tabela e mesipërme, likuidimi i detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore nuk është kryer sipas rradhës dhe në menyrë propocionale për sejcilin punonjës. Punonjësit A.N. është likuiduar pjesërisht dhe mbetet diferenca sipas viteve të poshtëshenuara dhe dhe Y.K. nuk u janë likuiduar asnjë lekë ndersa, V.N. dhe A.Sh. dhe R.F. i kanë marrë të gjithë detyrimet që kanë pasur për të marrë.

Ne zbatim te V.K.M nr. 335 date 02.06.1998 “Për procedurat për zbatimin e vendimeve për detyrimet qe prekin buxhetin e shtetit” Bashkia Kruje ka detyrime për vendimet gjyqësore sipas viteve.

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore që realizohen nga njësia shpenzuese, janë parashikuar të shlyhen nga buxheti përkatës në vitin 2015. Shlyerja e vendimeve gjyqësore konstatohet se nuk është kryer sipas rradhës së paraqitjes zyrtare në vitin paraardhës detyrimet monetare, duke shkelur *Udhëzimin nr.2, datë 06.02.2012.*

Mos ekzekutimi i vendimeve gjyqësore sipas rradhës së paraqitjes zyrtare në vitin paraardhës përbën shkelje të, germa a) e pikës 5, të Udhëzimit nr. 1, datë 04.06.2014 ku shprehet se:

*“Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore që janë parashikuar të shlyhen nga buxheti përkatës , bëhet sipas radhës së paraqitjes zyrtare të tyre në vitin paraardhës dhe grafiku i shlyerjes behet publik nëpërmjet publikimit në faqen on-realizohen të njësisë shpenzuese ”*

**3. Raportimi nga Kryetar i Bashkisë në Këshillin Bashkiak të gjendjes ekonomiko-financiare, të paktën njëherë në 6 muaj, sipas nenit 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, dhe për vitin 2016 e në vazhdim sipas nenit 64 të ligjit nr. 30/2015 dhe ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; i cili ka shfuqizuar ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000.**

Në zbatim të udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 Kryetari i Bashkisë ka raportuar pranë këshillit të bashkisë lidhur me zbatimin dhe realizimin e buxhetit të vitit 2015-2016. Raportimi është bërë me gojë dhe nuk disponohen materiale të këtij raportimi.

Raportimet e monitorimit përfshijnë informacione mbi arritjet në terma të vlerave si dhe janë shpjeguar shkaqet e mosrealizimit të radhuarve tatimore, por që nuk është shprehur rruga dhe mënyra se si do procedohet për realizimin të këtyre të ardhurave.

Në Bashkinë Krujë për vitin 2015-2016 nuk është audituar buxheti i Bashkisë pasi nuk ka pasur sektor auditimi.

Nga analiza e realizimit të ardhurave sipas viteve konstatohet se ato janë në kufijtë e 66 % për vitin 2014, mesatarisht 83 % për vitin 2015 dhe për vitin 2016 mesatarisht 113 %.

Duke analizuar këto të dhëna konstatohet se planifikimi i të ardhurave tatimore nuk është i studiuar, pasi në të përfshihen rezerva të paidentifikuara dhe të paparashikuara dhe të pashprehura në panin e të ardhurave tatimore.

Nuk janë dokumentuar dhe pasqyruar arsye ligjore të vonësës në miratimin e tij. Kjo shpreh mosvlerësimin real të administratës të Bashkisë në procesin e hartimit dhe miratimit të projektit buxhetit të viti ushtrimor.

#### ***Nga verifikimi rezultoi që:***

1. Nga auditimi i buxhetit të Bashkisë Krujë, konstatohet se miratimi i tyre është bërë bërë me shumë vonesë si: Në Bashkinë Krujë në vitin 2014 buxheti është miratuar me Vendimin e Këshillit nr. 9, datë 13.3.2014, në vitin 2015 është miratuar me Vendimin nr. 7, datë 17.02.2016, duke shkelur afate e përcaktuara në nenin 32 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 ku shprehet se: Këshilli i qeverisjes vendore, brenda datës 31 Dhjetor, miraton buxhetin vendor në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor. Në këto kushte miratimi me vonesë e buxhetit, ka sjellë vonesa dhe në vendimmarrje, që duhej të kryhet në kohë si për përcaktimin e numrin e punonjësve, pagat, strukturën organizative të Bashkisë shpenzimeve ,investimeve dhe të ardhurave.

Miratimi i buxheteve nga këshilli i Bashkisë janë kryer me vonesë në muajt Mars të viteve ushtrimore 2014-2016, duke mos treguar arsyet e kësaj vonese dhe duke mos parashikuar vështersit që sjedhin këto vonesa në implementimin e tij me efijence.

2. Shlyerja e detyrimeve monetare që rrjedhin nga vendime gjyqësore të formës prerë konstatohet se nuk janë kryer sipas radhës së paraqitjes zyrtare në vitin paraardhës.

3. Bashkia Krujë për vitin 2015-2016 nuk ka audituar buxhetin pasi nuk ka pasur të ngritur sektor auditimi.

4. Nuk ka dokumentim të Vlerësimit të situatës financiare të Bashkisë dhe nxjerrjen e mangësive dhe avantazheve gjatë zbatimit të reformës territoriale,

#### ***Miratimi me vonesë i buxhetit***

**Titulli i Gjetjes:** Miratimi me shumë vonesë i buxhetit të Bashkisë Krujë për vitet 2013-2016.

**Situata:** Në Bashkinë Krujë në vitin 2014 buxheti është miratuar me VKB nr. 9, datë 13.3.2014, në vitin 2015 me VKB nr. 7, datë 17.02.2016, duke shkelur afate e përcaktuara.

**Kriteri:** Sipas nenin 32 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 ku shprehet se: Këshilli i qeverisjes vendore, brenda datës 31 Dhjetor, miraton buxhetin vendor në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor.

**Ndikimi/ Efektit:** Miratimi me vonesë e buxhetit ka sjedhë vështersit në implementimin e përdorimit e burimeve të financimit për shpenzime jo sipas planit të parashikuar, dhe mos arkëtimin e të ardhurave sipas parashikimit në buxhetin e Bashkisë.

**Shkaku:** Kjo situatë ka ndodhur sepse këshilli i NJSH-ve, nuk është mbledhur sipas ligjit në afate, zbatimi i ligjit për miratimin e buxhetit ka qenë i pa vlerësuar drejtë nga drejtuesit e NJSh-ve dhe të këshillave të tyre.

**Rëndësia:** I lartë

**Rekomandime:** Kërkohej që të ndërjegjësohet administratë Bashkisë e në mënyrë të veçantë Këshilli i Bashkisë për paraqitjen e projekt vendimit për miratimin e buxhetit të trajtohet si një obligim tepër i rëndësishëm.

**Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore jo sipas rradhes paraqitjes.**

**Titulli i Gjetjes:** Mos ekzekutimi i vendimeve gjyqësore sipas radhës së paraqitjes zyrtare në vitin paraardhës

**Situata:** Likuidimi i detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore nuk është kryer sipas rradhës dhe në menyrë propocionale për sejcilin punonjës.

**Kriteri:** Baza ligjore për likuidimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore është germa a) e pikës 5, të Udhëzimit nr. 1, datë 04.06.2014 ku shprehet se:

*“Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore që janë parashikuar të shlyhen nga buxheti përkatës, bëhet sipas radhës së paraqitjes zyrtare të tyre në vitin paraardhës dhe grafikun i shlyerjes behet publik nëpërmjet publikimit në faqen on-realizohen të njësisë shpenzuese”.*

**Ndikimi/ Efektit:** Pasojat që mund të vijnë nga mos zbatimi radhës për likuidimin e vendimeve gjyqësore janë mosplanifikimi i saktë i këtyre detyrimeve dhe demi ekonomik që shkaktohet nga pagese penaliteteve me vonesë.

**Shkaku:** Së pari punonjësit e administratës nuk i njohin ligjet, së dyti mungesa e kontrollit në zbatimin e ligjit.

**Rëndësia:** I mesëm

**Rekomandime:** Për çdo vendim gjyqësor që prek fondet buxhetore të ketë analizë të përgjegjësi administrative për mos veprime në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, në largimin e punonjësve nga puna dhe pagesën e tyre pa bërë me parë një analize sipas pikës 62, Udhëzimi nr. 2, datë 06.02.2012. Marrja dhe dorëzimi dhe marrja e detyrës të kryhet konformë legjislacionit në fuqi.

### **III. MBI PËRPUTHSHMËRINË E PROCESIT TË TRANSFERIMIT TË DREJTAVE DHE DETYRIMEVE TË PREKURA NGA RIORGANIZIMI ADMINISTRATIVO-TERRITORIAL**

Vlerësim mbi mënyrën e bashkimit të aktivitetit të ish-komunave dhe zbatimi i procedurave të caktuara në VKM nr.510, datë 10.06.2015 *“Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”* si dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr.3237 datë 16.07.2015 *“Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”.*

*-Ngritja dhe funksionimi i grupit të punës për zbatimin e procedurave (Kreu II, i VKM), Vlerësimi i raportimeve periodike dhe informimi i strukturave përkatëse shtetërore, afatet ligjore në përgatitjen e Raportit të Kontrollit Operacional.*

Në zbatim të Kreut II “Grupi Punës për Zbatimin e Procedurave të Transferimit” të VKM nr. 510, datë 10.6.2015, mbështetur në ligjin nr.30/2015 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”i ndryshuar, Titullari i Bashkisë Krujë ka nxjerrë Urdhërin nr.81, datë

15.09.2015, për ngritjen e grupit të punës “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumenti zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”.

Grupi i punës i cili do të jetë përgjegjës për zbatimin e procedurave dhe detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i ligjit dhe vendimit të cituar më sipër përbehet nga 9 antarë dhe kryetarë grupi është N/Kryetari i Bashkisë Krujë.

Nga auditimi konstatohet se roli i e **funksionimi i grupit të punës nuk ka qënë funksionale**, eficiente në kryerjen e funksioneve që i janë ngarkuar, si për zbatimin e procedurave dhe detyrimet që rrjedhin nga riorganizimi i pushtetit vendorë në zbatim të ligjit nr.30/2015 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”i ndryshuar, ashtu dhe të raportimit në mënyrë periodike tek kryetari i bashkisë për zbatimin e detyrave dhe problemeve që kanë rezultuar në lidhje me riorganizimin.

–Nga auditimi kryer lidhur me dokumentimin problemeve të dala gjatë zbatimit të procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga riorganizimi administrative-territoriale si dhe informacionet e grupi punës për procesin e transferimit e të drejtave dhe detyrimeve nuk konstatuam se nuk ka dokumentuar problemet që kanë dalë nga zbatimi i reformes territoriale dhe organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore, bashkëpunimi dhe bashkërendimi me Agjencinë e Zbatimit të Reformës Territoriale si dhe me administratorët e NJSH-ve nuk ka qënë i mjaftueshëm në zgjidhjen e detyrave që janë përcaktuar në VKM nr. 510, datë 10.6.2015 për zgjidhjen e **problemeve që dalin nga Riorganizimi Administrativo-Territorial**.

–*Vlerësimi i përmbajtjes së Raportit mbi çështjet operacionale, si: strukturat administrative dhe përgjegjësitë; disponueshmëria e shërbimeve publike dhe funksioneve administrative; inventari i sistemeve të informacionit dhe kontratave të mirëmbajtjes; vlerësimi i kontrolleve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) të zbatuara në sistemet e informacionit; inventari i pajisjeve të TIK dhe marrëveshjeve të komunikimit; procedurat e arkivimit të dokumentacionit; menaxhimi i aktiveve; projektet e investimit; kontratat e shërbimeve publike; kontratat me palët e treta; çështjet gjyqësore (Shtjello në mënyrë të zgjeruar për secilën njësi shpenzuese)*

Është hartuar “Raport Kontrolli Operacional” i cili pasqyron një përmbledhje e të dhënave dhe gjetjeve për çështjet operacionale që përfshinë inventari i personelit, strukturat administrative dhe përgjegjësitë, shërbimeve publike dhe funksioneve administrative, menaxhimi i aktiveve; projektet e investimit; kontratat e shërbimeve publike; kontratat me palët e treta; çështjet gjyqësore. menaxhimi i aktiveve; projektet e investimit; kontratat e shërbimeve publike; kontratat me palët e treta; çështjet gjyqësore.

Njësit Administrative, Thumanë, Nikël, Bubq, Cudhi nuk kanë administruar në kushtet aktuale regjistra apo procedura të sakta përsa i përket arkivimit dhe protokollimit. Vihet re që procedura e operacioneve ditore te arkivimit nuk zbatohet dhe problemi me shqetësues është mungesa e inventarëve të rregullt të arkivimit.

Mungesa e procedurave të sakta të regjistrimit ka krijuar veshtersi në procesin e transferimit te dokumentacionit në bashkinë e re. Bashkia e re duhet të krijojë regjistra të saktë dhe procedura të plota përsa i përket arkivimit në mënyrë që të transferohet dhe mbahet nën kontroll dokumentacioni

Njësitë Administrative nuk kanë të shkruara apo të aprovuara në rregullore probleme si: për sa i përket kontrollit të brëndshëm, ndarjes së detyrave, programeve të trajnimit të aprovuara, etj. Një problem madhor është mungesa e politikave dhe procedurave përsa i përket periudhës së mbylljes së librave kontabël të cilat duhet t’i përshtaten ligjit të buxhetit të shtetit.

Mungesa e stafit të TI-së mund të krijojë probleme të rëndesishëm për mbarvajtjen e punës në bashki plotësimi i orgganikë me specialist të fushë, për nevojave që lindin në sistemin e TI-së është i rëndesishëm pasi ky system është i rrezikuar. Keq funksionimi apo ndërprejra e sistemeve kompjuterikë mund të krijojë probleme në mbarëvajtjen e punës. Mungesa e stafit të TI-së rezulton në vonesë në rregullimin e avarive kompjuterike.

*Në se perfshin raporti informacion te plote mbi çështjet financiare, si buxheti; aktivet afatgjata materiale; inventari; debitorët dhe të tjera të arkëtueshme; gjendja e likuiditeteve; kreditorët; shpenzimet; te ardhurat; investimet në filiale; grantet nga donatorë të huaj; financimi dhe shpenzimet e lidhura me investimet; pasqyra e rrjedhjes së parasë; pasqyra e balancave dhe ndryshimeve gjatë vitit të aktiveve të qëndrueshme; pasqyra e amortizimit të aktiveve të qëndrueshme; pasqyra e ndryshimit të fondit etj.*

Nga auditimi “Raporti i Kontrollit Financiar” konstatohet se: rregjistrat e pronave të bashksë nuk janë të plotësuar me gjithë të dhenat e domosdoshme të këtyre pronave. Nga ky kendveshtrim ekziston rreziku që Njësitë Administrative mund të mos identifikojë dhe ti administrojë pronat që i janë vënë në dispozicion edhe për faktin se nësë mbi 90% ato nuk janë hipotekuar. Prandaj kerkohet hartimi i regjistrime të sakta të aktiveve në mënyrë të saktë prandaj pasqyrat financiare mund të kenë shmangie ose gabime. Për më tepër, mungesa e një regjistri përkatëstë aktiveve mund të ndikojë në transferimin e tyre.

Konstatohet së Bashkia akoma nuk ka krijuar regjistrin e duhur për kreditorët me të dhëna të sakta, me qëllim identifikimin e furnizuesit për mallra dhe shërbime dhe gjithashtu, të planifikojë siç duhet pagesat e këtyre kreditorëve. Nga ana e Bashkisë konstatohet se shlyerja e detyrimeve nuk bëhet sipas radhës së krijimit dhe shlyerjes në kohë të njëjtë në menyre proporcionale sipas fondeve të vëna në dispozicion.

Deri më sot bashkia nuk ka arkivuar gjithë dokumentacionin i cili duhej të arkivohej në bashki, si Urdhër-shpenzimet me pagesat e kryera për shpenzimet dhe pagat e punonjësve Përveç NJSH-ve Cudhi, Fushë-Krujë NJSHT, Bubq, Thumanë e Nikël, nuk janë arkivuar dokumentacionin e bankës si dhe atë të pagesës së punonjësve, keto parregullsitë duhet menjëherë te rregullohen.

Konstatohet pasqyrat financiare të paraqitura reflektojnë rregullime të cilat janë indentifikuar dhe paraqitur në raportet individuale të NJSH-ve raporti informacion te plote mbi çështjet financiare është hartuar sipas rregullave të përcaktuara nga MF.

*Afati i përgatitjes së “Raportit të Konsoliduar të Kontrollit”, bazuar në afatin ligjor brenda muajit nëntor 2015, nga Bashkia.*

Raportit të Konsoliduar të Kontrollit, është hartuar me ndihmen Grand Thorton shpk dhe UNDP Albania në të cilën janë indentifikuar çështjet dhe mangesitë specifike që mund të ndikojnë në rezultatet e pritshme të raporteve të kontrollit si dhe në rezultatet e procesit bashkimit. Këto çështjet dhe mangesitë specifike janë trajtuar më lart.

Afati i përgatitjes së “Raportit të Konsoliduar të Kontrollit”, bazuar në afatin ligjor brenda muajit nëntor 2015, nga Bashkia Krujë është paraqitur me datë 24.12.2015, një muaj me vonesë.

***Nga verifikimi rezultoi që:***

1. Funksionimi i grupit të punës nuk ka qënë funksionale, efiçente në kryerjen e funksioneve që i janë ngarkuar nga Titullari.
2. Grupit të punës nuk ka dokumentuar problemet që ekzistoni si dhe bashkerenduar dhe bashkepunimin e grupi punës me Agjencinë e Zbatimit të Reformës Territoriale si dhe me administratorët e NJSH-ve.
3. Në disa Njësit Administrative, Thumanë, Nikël, Bubq, Cudhi nuk kanë në përmbajtje regjistra apo procedura të sakta përsa i përket arkivimit dhe protokollimit.



4. Rregjistrat e pronave të bashksë nuk janë të plotësuar me gjithë të dhenat e domosdoshme të këtyre pronave si dhe nuk janë berë përpjekje për hipotekimin e tyre.
5. Nga auditimi konstatohet se nga Bashkia Krujë nuk është hartuar një program punë për të trajtuar dhe zgjidhur gjetjet kryesore,financiare dhe operationale të ndeshura në raportin e kontrollit të ekipit të projektit Star UNDP Albania.

### ***Funksionimi i grupit të punës për zbatimin e procedurave të transferimit të NJSH-ve***

**Titulli i Gjetjes:** Grupi Punës i ngritur për Zbatimin e Procedurave të Transferimit nuk e ka kryer funksionin e ngarkuar.

**Situata:** Në zbatim të Kreut II “ Grupi Punës për Zbatimin e Procedurave të Transferimit” të VKM nr. 510, datë 10.6.2015, mbeshteur në ligjin nr.30/2015 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, Titullari i Bashkisë Krujë ka nxjerrë Urdhërin nr.81, datë 15.09.2015, për ngritjen e grupit të punës “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumenti zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial.

Gjatë zbatimit të procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga riorganizimi administrative-territoriale si dhe nformacionet e grupi punës për procesin e transferimit e të drejtave dhe detyrimeve nuk ka kryer si duhet detyrat e ngarkuar si dhe nuk ka dokumentuar problemet që kanë dalë nga zbatimi i reformës territoriale dhe organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore, si ë regjistrimin e pronave, transferimin e arkivave, transferimin e punonjësve etj.

**Kriteri:** Baza ligjore për kryerjen e aktivitetit të grupit punës ka qenë VKM nr. 510, datë 10.6.2015, Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial” Urdhërin nr. 81, datë 15.09.2015, për ngritjen e grupit të punës.

**Ndikimi/ Efektit:** Për pasojë konstatohet se regjistrimi i pronave të Bashkisë, transferimi i arkivave dhe punonjësve ka hasur në shumë pengesa, të cilat e kanë bërë të pa mundur zbatimin e tyre.

**Shkaku:** Nuk është ushtruar kontroll ndaj Grupi të punës që përbehej nga 9 persona, si dhe ky grup nuk ka pasur të qartë detyrën që do kryente.

**Rëndësia:** I lartë

**Rekomandime:** Në mbështetje të pikës 6, të Kreut II të VKM nr. 510, datë 10.6.2015,i propozojmë Kryetarit Bashkisë të marrë masë administrative ndaj punonjësve që e kanë pasur si detyrë të zbatonin sipas pikës 1, kreu IV “Transferimi I personelit”. të VKM nr. 510, datë 10.6.2015.

### **III.1 TRANSFERIMI I TE DREJTAVE DHE DETYRIMEVE (KREU III, I VKM)**

Në zbatim të pikës III Mbi Përputhshmërinë e Procesit të Transferimit të të Drejtave dhe Detyrimeve të Prekura nga Organizimi Administrativo-Territorial, pikës III.2 Transferimi i Personelit, pikës III.3 Transferimi i Arkivave (Kreu V, i VKM të programit të auditimit “Nr.776/1, datë 24/07/ 2017 mbajtur në datë 28/09/2017”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Me shkresën Nr. 1652, datë 28.08.2015 janë njoftuar Njesitë Administrative Fushë-Kruje dhe ish komunat, Thumanë, Nikël, Bubq e Cudhi për dorëzimin e dosjeve të punonjësve në zyrën e personelit të Bashkisë Krujë në zbatim të germës ç) të Kreut IV “Transferimi i Personelit” të VKM nr. 510, datë 10.6.2015, ku shprehet se: Dosjet e personelit duhet të depozitohen pranë bashkisë jo më vonë se një muaj nga momenti i konstituimit të organeve të saj. Nga auditimi konstatohet se dosjet e NJSH-ve janë tërhequr nga Sektori i burimeve njerëzore të bashkisë Krujë brenda afatit të përcaktuar nga VKM nr. 510, datë 10.6.2015, si më poshtë:

*Dosjet e punonjësve të NJSH-ve janë tërhequr sipas procesverbaleve të mbajtura në NJSH-së Fushë Krujë me datë 28.08.2015, NJSH-së Thumanë me datë 31.08.2015, NJSH-së Nikël me datë 28.08.2015, NJSH-së Bubq me datë 28.08.2015, NJSH-së Cudhi me datë 31.08.2015.*

Në bashkinë Fushë-Krujë u konstatuan se tre punonjës me kontratë ishin pa dosje, në ish komunën Bubq dy punonjës rezultojnë pa dosje personeli, në ish komunën Cudhi u konstatuan tre punonjës pa dosje personeli, ndërsa ish komuna Nikel ka dorëzuar 15 dosje më tepër se numri i punonjësve aktuale që punonin, dosje këto të punëtorëve sezonal të larguar më parë nga mbarimi i kontratës provizore nuk janë tërhequr nga këto punonjës.

**Konstatohet se dosjet e personelit janë depozituar pranë Bashkisë Krujë**, duke zbatuar kështu VKM nr. 510, datë 10.6.2015, germës ç), të Kreut IV, "Transferimi i Personelit" ku, shprehet se dosjet e personelit duhet të depozitohen pranë bashkisë jo më vonë se një muaj nga momenti i konstituimit të organeve të saj.

**Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:**

1. Ligjin ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, të Ligjit nr.115/2014, "Për ndarjen administrative-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", Ligjin ligjit nr.7961, datë 12.7.1995, 'Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë'

2. VKM Nr.510, datë 10.6.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumenti zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial".

3. Udhëzimin nr.3237, datë 16.7.2015, Vendimin e Këshillit Bashkisë nr. 49, datë 31.08.2015. "Miratuar Struktura tranzitore e punonjësve të Bashkisë".

Nga auditimi u konstatue se Bashkia Krujë kur ka hartuar strukturën e organikës së NJSH Fushë-Krujë ka mbajtur në punë një punonjëse arkivist deri më sot, hartimi i kësaj organike dhe mbajtja në punë si arkiviste është në kundërshtim me pikën 3, të Kreut V, të VKM nr. 510, datë 10.6.2015 ku shprehet se: Arkivat e NJSH-ve mund të vazhdojnë të ekzistojnë edhe pas konstituimit të bashkisë, por gjithsesi, por jo më shumë se 6 muaj nga ky moment. Në këto kushte mbajtja e organikës së arkivit të NJSH-ë është në shkelje të VKM nr. 510, datë 10.6.2015 dhe përbën **dem ekonomik në vlerën 519,870 lekë**, pagesa e saj është kryer deri në fund të vitit 2016 që është dhe afati i periudhës së audituar.

*Dokumentet në ruajtje të përkohshme, për të cilat nuk ka përfunduar afati i ruajtjes, duhet të vazhdojnë të ruhen pranë NJSH-së deri në transferimin pranë Bashkisë, pasi të jenë krijuar hapësirat e nevojshme. Për këtë, arkivat e NJSH-ve mund të vazhdojnë të ekzistojnë edhe më pas pas pas konstituimit të bashkisë, por, gjithsesi, për jo më shumë se 6 muaj nga ky moment., ato vazhdojnë të mbahen në NJSH-të edhe gjatë kohës së auditimit 2 vjet pas riorganizimit të pushtetit vendorë. Në këto kushte pagesa e specialistëve të arkivës së NJSH-së Thumanë në vlerën **486,420 lekë**, është kryer në shkelje të VKM nr. 510, datë 10.6.2015 dhe si e tillë përbën dem ekonomik.*

1. Urdhërin nr.81, datë 15.09.2015, ngritja e grupit të punës "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumenti zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial".

2. Vendimi i Këshillit Bashkisë Krujë nr.49, datë 31.8.2015 "Për miratimin e numërit të punonjësve të bashkisë Krujë, Institucionet e varësisë dhe Njësit administrative".

3. Urdhri i Kryetarit bashkisë nr. 71, datë 15.09.2015, "Miratuar numëri i punonjësve gjithsej, ndarë kjo në 59 punonjës me status Nepunesi Civil dhe 214 punonjës me kontratë".

4. Shkresa e Kryetarit Bashkisë Nr. 1652, datë 28.08.2015, "Njoftuar Njësitë Administrative Fushë-Krujë dhe ish komunat, Thumanë, Nikël, Bubq e Cudhi për dorëzimin e dosjeve të

punonjësve në zyrën e personelit të Bashkisë Krujë në zbatim të gërmës ç) të Kreut IV “Transferimi i Personelit”.

5. Urdhri i Kryetarit të Bashkisë Krujë nr. 115, datë 20.10.2015, “Largimi i punonjësve si rezultat i ristrukturimit të Njësive Vendore të bashkisë Krujë”.

6. Vendimin e Këshillit bashkisë Nr. 49, datë 31.08.2015. “Miratuar Struktura tranzitore e punonjësve të Bashkisë”.

Megjithëse VKB Krujë Nr. 49, datë 31.08.2015 “Për ristrukturimin e numrit të punonjësve” është marrë brenda muajit nga marrja e mandatit të kryetarit, pra brenda afatit të përcaktuar në Kreu IV, të VKM Nr. 510, datë 10.6.2015, **njoftimi për shkurtimin e punonjësve është marrë me datë 29.09.2015, pra një muaj me vonesë sipas përcaktimit të VKM Nr. 510, datë 10.6.2015, për shkak e struktura tranzitore është miratuar me urdhrin nr. 71, datë 15.09.2015 me 263 punonjës gjithsej, ndarë kjo në 59 punonjës me status Nëpunësi Civil dhe 214 punonjës me kontratë.**

Me urdhrin nr. 71, datë 15.09.2015 është miratuar struktura organizative provizore e bashkisë dhe e Njësive Administrative me 263 punonjës gjithsej, ndarë kjo në 59 punonjës me status Nëpunësi civil dhe 204 punonjës me kontratë.

Për këto punonjës marrëdhënia e punës transferohet automatikisht që deri me datë 30 shtator sipas përcaktimit të VKM nr. 510, datë 10.06.2015.

Brenda pesë muajve nga data e konstituimit të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive, bashkia duhet të ketë kryer procedurat, sipas pikës 1, kreu IV “Transferimi i personelit”. Për të mundësuar transferimin dhe pozicionimin në kohë të personelit, sipas pikës 1, dosjet e personelit të NJSH-së duhet të depozitohen pranë bashkisë **Jo më vonë se një muaj** nga momenti i konstituimit të organeve të saj. Ngarkohen personat përgjegjës për çështjet e personelit në NJSH për plotësimin e këtij detyrimi, brenda afatit të përcaktuar.

Me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Krujë nr. 115, datë 20.10.2015, janë larguar 116 punonjës nga pozicionet e tyre me kontratë sipas kodit punës, si rezultat i ristrukturimit të Njësive Vendore në zbatim të ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM nr. 510, datë 10.6.2015, Këshilli i Bashkisë Krujë me VKB nr. 49, datë 31.08.2015 “Miratimi i strukturës dhe numrit të punonjësve të Bashkisë Krujë” prej 263 punonjësish.

Nga këto punonjës të larguar nga puna nga ish bashkia Fushë-Krujë, vetëm ish roja e Bashkisë Fushë-Krujë Qemal Qela, është ankuar në gjykatën e shkallës parë Krujë, e cila është me vendimin nr. 80-2016-3236, datë 22.6.2016, ka rrezuar pjesërisht pretendimin e tij për kthimin në vendin e punës, por të paguhet me 10 paga mujore nga ana bashkisë ky vendim është apeluar.

**Mbajtja në punë e arkivisteve në kundërshtim me përcaktimin e VKM nr. 510, datë 10.6.2015.**

**Titulli i Gjetjes:** Lidhur me miratimin e numërit të punonjësve të Bashkisë Krujë, Institucionet e varësisë dhe Njesit administrative në kundërshtim mes legjisllacionin.

**Situata.** Hartimi dhe aplikimi në organikën e arkivit të NJSH-të një arkiviste është në shkelje të VKM nr. 510, datë 10.6.2015 dhe përbën **dem ekonomik në vlerën 519,870 lekë nga NJSH-ja Fushë-Krujë,** dhe në NJSH-ne Thumanë pagesa e saj deri në fund të vitit 2016 që është dhe afati i periudhës së audituar. Në arkivën e NJSH-së Thumanë është mbajtur në punë si arkivist dhe është paguar në vlerën **486,420 lek,** keto veprime janë kryer në shkelje të VKM nr. 510, datë 10.6.2015 dhe si e tillë përbën dem ekonomik.

**Kriteri:** Mbajtja në punë si arkiviste në NJSH-të, është në kundërshtim me pike 3, të Kreu V, të VKM nr. 510, datë 10.6.2015 ku shprehet se: Arkivat e NJSH-ve mund të vazhdojnë të ekzistojnë edhe pas konstituivit të Bashkisë por, gjithsesi, por jo më shumë se 6 muaj nga ky moment.

**Ndikimi/ Efektit:** Tejkalimi i fondit pagave me vlerën 4,729,050 lekë.

**Shkaku:** Kjo situatë ka ndodhur pasi me miratimin e ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrative-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM nr. 510, datë 10.6.2015 dhe Këshilli i Bashkisë Krujë me VKB nr. 49, datë 31.08.2015 Bashkia nuk ka marrë masa të menjëhershme për hartimin e organikes dhe transferimin e arkivave në qendër sipas legjislacionit të miratuar.

**Rëndësia:** I lartë.

**Rekomandime:** Për Mospërmbushje të detyrimit për bashkë-punim dhe informim, në zbatim të nr. 510, datë 10.6.2015, në mbështetje të pikës 6 të Kreut II të VKM nr. 510, datë 10.6.2015. I propozojmë Kryetarit Bashkisë të marrë masë administrative ndaj Grupit të punës të ngritur sipas Urdhërin nr.81, datë 15.09.2015, “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumenti zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”.

### **III.2 TRANSFERIMI I PERSONELIT (Kreu IV, i VKM)**

Në zbatim të pikës III Mbi Përputhshmërinë e Procesit të Transferimit të të Drejtave dhe Detyrimeve të Prekura nga Organizimi Administrativo- Territorial, pikës III.2 Transferimi i Personelit, pikës III.3 Transferimi i Arkivave (Kreu V, i VKM të programit të auditimit “Nr.776/1, datë 24/07/ 2017, mbajtur në datë 28/09/2017” u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

*Me shkresën Nr.1652, datë 28.08.2015 janë njoftuar Njesitë Administrative Fushë-Kruje dhe ish komunat, Thumanë, Nikël, Bubq e Cudhi për dorzimin e dosjeve të punonjësve në zyrën e personelit të Bashkisë Krujë në zbatim të germës ç) të Kreut IV “Transferimi i Personelit” të VKM Nr. 510, datë 10.6.2015, ku shprehet se: Dosjet e personelit duhet të depozitohen pranë bashkisë jo më vonë se një muaj nga momenti i konstituimit të organeve të saj. Nga auditimi konstatohet se dosjet e NJSH-ve janë tërhequr nga Sektori i burimeve njerëzore të bashkisë Krujë brenda afatit të përcaktuar nga VKM nr. 510, datë 10.6.2015 si më poshtë:*

*Dosjet e punonjësve të NJSH-ve janë tërhequr sipas procesverbaleve të mbajtura në NJSH-së Fushë Krujë me datë 28.08.2015, NJSH-së Thumanë me datë 31.08.2015, NJSH-së Nikël me datë 28.08.2015, NJSH-së Bubq me datë 28.08.2015, NJSH-së Cudhi me datë 31.08.2015.*

Në Bashkinë Fushë -Krujë u konstatuan se tre punonjës me kontratë ishin pa dosje, në ish komunën Bubq dy punonjës rezultojnë pa dosje personeli, në ish komunën Cudhi u konstatuan tre punonjës pa dosje personeli, ndërsa ish komuna Nikël ka dorëzuar 15 dosje më tepër se numri i punonjësve aktuale që punonin, dosje këto të punëtorëve sezonal të larguar më parë nga mbarimi i kontratës provizore nuk janë tërhequr nga këto punonjës.

**Konstatohet se dosjet e personelit janë depozituar pranë Bashkisë Krujë,** duke zbatuar kështu VKM nr. 510, datë 10.6.2015, germës ç), të Kreut IV, “Transferimi i Personelit” të , ku shprehet se dosjet e personelit duhet të depozitohen pranë bashkisë jo më vonë se një muaj nga momenti i konstituimit të organeve të saj.

**Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:**

1. Ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, të Ligjit nr.115/2014, “Për ndarjen administrative-territorial të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin ligjit nr.7961, datë 12.7.1995, ‘Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë’
2. VKM Nr.510, datë 10.6.2015.
3. Udhëzimin Nr.3237, datë 16.7.2015.
4. Me Vendimin e Këshillit Bashkisë Nr.49, datë 31.08.2015. është Miratuar Struktura tranzitore e punonjësve të Bashkisë.

*Me urdhrin nr. 71, datë 15.09.2015 është miratuar struktura organizative provizore e bashkisë dhe e Njësive Administrative me 263 punonjës gjithsej, ndarë kjo në 59 punonjës me status Njësia civil dhe 204 punonjës me kontratë. Për këto punonjës marrëdhënia e punës transferohet automatikisht që deri me datë 30 shtator sipas përcaktimit të VKM nr. 510, datë 10.06.2015.*

Brenda pesë muajve nga data e konstituimit të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive, Bashkia duhet të ketë kryer procedurat, sipas pikës 1, kreu IV “Transferimi I personelit”. Për të mundësuar transferimin dhe pozicionimin në kohë të personelit, sipas pikës 1, dosjet e personelit të NJSH-së duhet të depozitohen pranë bashkisë **Jo më vonë se një muaj** nga momenti i konstituimit të organeve të saj. Ngarkohen personat përgjegjës për çështjet e personelit në NJSH për plotësimin e këtij detyrimi Brenda afatit të përcaktuar.

Me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Krujë nr. 115, datë 20.10.2015, janë larguar 116 punonjës nga pozicionet e tyre me kontratë sipas kodit punës, si rezultat i ristrukturimit të Njësive Vendore në zbatim të ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Rpublikën e Shqipërisë” dhe VKM nr. 510, datë 10.6.2015, Këshilli i Bashkisë Krujë me VKB nr. 49, datë 31.08.2015 “Miratimi i strukturës dhe numrit të punonjësve të Bashkisë Krujë” prej 263 punonjësish.

Nga këto punonjës të larguar nga puna nga ish bashkia Fushë-Krujë, vetëm ish roja e Bashkisë Fushë-Krujë Q.Q, është ankuar në gjykatën e shkallës parë Krujë, e cila është me vendimin nr. 80-2016-3236, datë 22.6.2016, ka rrezuar pjesërisht pretendimin e tij për kthimin në vendin e punës, por të paguhet me 10 paga mujore nga ana bashkisë ky vendim është apeluar.

Siç konstatohet nga auditimi listë pagesave të gjithë punonjësit e NJSH-ve, **janë paguar në muajin shtator të vitit 2015 përfshirë edhe ato punonjës që duhet tu behej njoftimi për shkurtimin e vendeve të punës si rezultat të riorganizimit të pushtetit vendor** të gjithë punonjësit e Bashkisë Krujë, pra njoftimi për shkurtimin e vendeve të punës të punonjësve është kryer një muaj me vonesë, ky njoftim është bërë në muajin tetor, duke tejkaluar afatin e njoftimit të shkurtimit të vendeve të punës të punonjësve struktura një muaj më tepër, si rezultat i kësaj vonese janë **paguar me tepër seç e përcakton Kreu IV të VKM Nr.510, datë 10.6.2015 në vlerën 3,728,760 lekë, në këtë VKM përcaktohet se: Marrëdhëniet e punës ekzistuese, ndërmjet NJSH-ve dhe punonjësve të tyre, do të transferohen në Bashki, në momentin e konstituimit të organeve të saj. Nga momenti i konstituimit deri në miratimin e strukturës administrative përfundimtare, bashkia është në proces ristrukturimi dhe operon me strukturë transitore, e cila miratohet nga kryetari i saj, brenda 1 muaji nga marrja e mandatit.**

Bashkia Krujë nga momenti i konstituimit të organeve të sajë deri në miratimin e strukturës administrative përfundimtare ka hartuar strukturën provizore, e cila është miratuar me VKB nr. 49, datë 31.08.2015, por procedurat e njoftimi të punonjësve për shkurtimin e vendeve të punës kanë filluar me datën 1 Tetor 2015.

Konstatimi i mësipërm, evidentohet më konkretisht në tabelën e mëposhtme ku janë emerat e punonjësve që janë bërë njoftimet e largimit nga puna si rezultat e ristrukturimit të pushtetit vendor.

**Titulli i Gjetjes:** Bashkia nuk ka kryer procedurat, sipas pikës 1, kreu IV “Transferimi i personelit” të VKM Nr.510, datë 10.6.2015, për largimin e punonjësve të shkurtuar nga reforma.

**Situata:** Mos transferimin dhe pozicionimin në kohë të personelit, sipas pikës 1, dosjet e personelit të NJSH-së. Siç konstatohet janë paguar me tepër seç e përcakton Kreu IV të VKM Nr. 510, datë 10.6.2015 **në vlerën 3,728,760 lekë**, në këtë VKM përcaktohet se: Marrëdhëniet e punës ekzistuese, ndërmjet NJSH-ve dhe punonjësve të tyre, do të transferohen në Bashki,

në momentin e konstituimit të organeve të saj. Nga momenti i konstituimit deri në miratimin e strukturës administrative përfundimtare, bashkia është në proces ristrukturimi dhe operon me strukturë transitorë, e cila miratohet nga kryetari i saj, brenda 1 muaji nga marrja e mandatit.

**Kriteri:** Kriteret për shkurtimin e punonjësve si rezultat i reformës territoriale të përcaktuara në *Kreu IV të VKM Nr. 510, datë 10.6.2015*.

**Ndikimi/ Efektit:** Si pasojë e mos njoftimit në kohë për ndërprerjes marrëdhëniet e punës me vonesë të punonjësve të parashikuar për tu shkurtuar me një muaj, është tejkaluar fondin e pagave në vlerën 3,728,760 lekë.

**Shkaku:** Mos ndjekjes procedurave dhe mos zbatimin i *Kreu IV të VKM-së VKM Nr.510, datë 10.6.2015*.

**Rëndësia:** I lartë.

**Rekomandime:** Në mbështetje të pikës 6, të *Kreut II të VKM nr. 510, datë 10.6.2015*, i propozojmë Kryetarit Bashkisë të marrë masë administrative ndaj punonjësve që e kanë pasur si detyrë të zbatonin sipas pikës 1, kreu IV “Transferimi I personelit”. të *VKM nr. 510, datë 10.6.2015*.

### III.3 TRANSFERIMI I ARKIVAVE (KREU V, I VKM)

Sigurimi i ambienteve të përshtatshme për dokumentacionin që do transferohet nga NJSH-të në Bashkinë Krujë dhe në arkivat e shtetit.

Ndërtesës Bashkisë Krujë i është nënshtruar një rikonstruksioni i plotë sipas kontratës me datë 14.9.2016 me një afta 6/mujorë, pra deri në fund të marsit 2017, në këto kushte nuk ka qenë mundësia e transferimit të dokumenteve arkivore të NJSH-ve në Bashkinë Krujë.

Nga verifikimi i gjendjes së arkivave në njësitë vendore (NJSH-të) Bubq, Nikël Cudhi rezultoi që: dokumentet vazhdojnë të mbahen në ish arkivat e NJSH-ve, me gjithëse se organika e arkivistëve është shkuartuar: Sipas ligjit nr.30/2015, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar VKM nr.510, datë 10.6.2015 Bashkia Krujë është trashëgimtari ligjor i njësisve të qeverisjes vendore të njësisve që janë shkriretë në të Bashkia Krujë si ish bashkia Fush-Krujë, ish komunat Thumanë, Nikël, Bubq, Cudhi. Me konstituimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet ekonomike, financiare, sociale apo të tjera, të karakterit civil dhe administrativ, të njësisve të qeverisjes vendore që janë shkriretë, përfshirë edhe të gjitha detyrimet që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë.

Për zbatimin e procedurave të transferimit ngrihet grupi i punës në çdo bashki. Grupi i punës ngrihet me urdhër të Kryetarit të bashkisë, drejtohet nga nënkryetari i saj dhe ka në përbërje, të paktën, një përgjegjës finance, një jurist, një specialist të arkivit dhe një specialist të burimeve njerëzore.

*Me Urdhrin nr. 81, datë 15.09.2015, është kryer ngritja e grupit të punës “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumenti zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”.*

Nga auditimi konstatohet se Grupi i Punës i ngritur me *Urdhrin nr. 81, datë 15.09.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumenti zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”* nuk është shprehur mbi praktikën e arkivimit, bazuar në analizën për NJSH-në Fushë-Krujë, si dhe nuk ka hartuar një përmbledhje të vëzhgimeve dhe rekomandimeve për aktivitetin e arkivimit sipas përcaktimeve dhe të detyrave të ngarkuara nga *Udhëzimi i Përbashkët i Ministrisë për Çështjet Vendore dhe Ministrisë Financave nr. 3237, datë 16.7.2015 “Për procedurat, afatet kohore, standartet dhe*

*kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm, për riorganizimin administrativo-territorial”.*

Nga auditimi i arkivave të NJSH-ve, Nikël, Bubq, Cudhi, konstatohet se deri në muajin shtator të vitit 2017, dokumentacioni i këtyre subjekteve deri më sot nuk është arkivuar në pranë arkivave shtetërore vendore, sipas juridiksionit territorial si dhe pranë bashkisë Krujë si dhe nuk është kryer përpunimi i tyre sipas viteve sipas pikës 2, Kreu V, të VKM nr. 510, datë 10.6.2015 ku shprehet se: *NJSH-të, përpara datës së dorëzimit të dokumentacionit pranë bashkisë, duhet të kenë përfunduar përpunimin për dokumentacionin e viteve të mëparshme, përfshirë atë të vitit 2014. Përpunimi apo klasifikimi sipas fondeve duhet të kryhet në përputhje me normat teknike profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, të miratuara me vendimin nr. 1, datë 16.1.2004, të Këshillit të Lartë të Arkivave, në mbështetje të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”. Në kryerjen e këtij procesi, NJSH-të do të mbikëqyren nga arkivi shtetëror vendor përkatës, sipas pikës 3, Kreu V, Transferimi i Arkivave dhe Dokumentacionit e VKM nr. 510, datë 10.6.2015, ku shprehet se:*

*“Dokumentet arkivore, të sistemuara dhe inventarizuara sipas pikës 2, me mbarimin e afatit të shërbimit operativ pranë NJSH-së, do të dorëzohen për ruajtje dhe administrim pranë arkivave shtetërore vendore, sipas juridiksionit territorial përkatës. Në rast rreziku të dukshëm, dëmtimi a zhdukjeje fizike, arkivat shtetërore vendore mund të tërheqin për ruajtje dhe administrim edhe dokumente arkivore për të cilat nuk ka përfunduar afati ligjor i shërbimit operativ pranë NJSH-së”.*

*Verifikimi i mbikëqyrjes nga arkivi shtetëror i njësite që shkrihen për përpunimin e dokumentacionit të viteve të mëparshme sipas normave tekniko profesionale dhe metodologjike.*

Dokumentet që janë prodhuar para datës 01.01.2015 dhe të vitit 2015, janë dorëzuar me proces verbal, brenda afatit dy mujor nga konstituimi i organeve të Bashkisë.

Konstatohet se Dokumentet në ruajtje të përkohshme, për të cilat nuk ka përfunduar afati i ruajtjes, duhet të vazhdojnë të ruhen pranë NJSH-së deri në transferimin pranë Bashkisë.

Nuk janë transferuar arkivat e këtyre NJSH-ve deri më sot, edhe se janë krijuar hapësirat e nevojshme në Bashkinë Krujë.

**Titulli i Gjetjes:** Nuk janë transferuar arkivat e këtyre NJSH-ve deri më sot, edhe se janë krijuar hapësirat e nevojshme në Bashkinë Krujë.

**Situata:** Nga auditimi i arkivave të NJSH-ve, Nikël, Bubq, Cudhi, konstatohet se edhe sot në muajin shator të vitit 2017, dokumentacioni i këtyre subjekteve deri më sot nuk është arkivuar në pranë arkivave shtetërore vendore, sipas juridiksionit territorial si dhe pranë bashkisë Krujë si dhe nuk është kryer përpunimi i tyre sipas viteve sipas pikës 2, Kreu V, të VKM nr. 510, datë 10.6.2015 ku shprehet se: *NJSH-të, përpara datës së dorëzimit të dokumentacionit pranë bashkisë, duhet të kenë përfunduar përpunimin për dokumentacionin e viteve të mëparshme, përfshirë atë të vitit 2014. Përpunimi apo klasifikimi sipas fondeve duhet të kryhet në përputhje me normat teknike profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, të miratuara me vendimin nr. 1, datë 16.1.2004, të Këshillit të Lartë të Arkivave, në mbështetje të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”. Në kryerjen e këtij procesi, NJSH-të do të mbikëqyren nga arkivi shtetëror vendor përkatës, sipas pikës 3, Kreu V, Transferimi i Arkivave dhe Dokumentacionit e VKM nr. 510, datë 10.6. 2015.*

**Kriteri:** Dokumentet arkivore, të sistemuara dhe inventarizuar sipas pikës 2, Kreu V, të VKM nr. 510, datë 10.6.2015, nuk janë dorëzuar pranë arkivave shtetërore vendore. Arkivat e NJSH-ve mund të vazhdojnë të ekzistojnë edhe pas konstituivit të Bashkisë, por gjithsesi jo më shumë se 6 muaj nga ky moment.

**Ndikimi/ Efektit:** Mos arkivimi i dokumenteve arkivore, krijohen mundësinë e rritjes rrezikut të dëmtimit apo zhdukjes fizike arkivave shtetërore vendore.

**Shkaku:** Grupi i punës i ngritur për zbatimin e procedurave të transferimit, nuk ka funksionuar për kryerjen e këtij procesi.

**Rëndësia:** I mesëm,

**Rekomandime:** Bashkia Krujë të marrë masa të menjëhershme për transferimin e dokumenteve arkivore, pasi të jenë të sistemuara dhe inventarizuara sipas pikës 2 e 3 të Kreut V, të VKM nr. 510, datë 10.6.2015, si dhe të dorëzohen për ruajtje dhe administrim pranë arkivave shtetërore vendore, sipas juridiksionit territorial përkatës.

**Rekomandime:** Të analizohen nga ana Titullarit Bashkisë arsyet e mos transferimit të dokumentacioneve arkivore sipas juridiksionit territorial, si dhe pranë Bashkisë Krujë, si dhe të nxirret përgjegjesia sipas përcaktimit të pikës 6 të Kreut II të VKM nr. 510, datë 10.6.2015.

#### III.4 TRANSFERIMI I PASURIVE DHE REGJISTRIT TE PASURIVE TE PALUAJTESHME (KREU VI, I VKM)

Bashkia Krujë, është subjekti juridik që trashëgon të drejtat e pronësisë, të luajtshme dhe të paluajtshme, të pesë ish njësive, ish Bashkisë **Fushë-Krujë**, si dhe 4 ish komunitat; **Kodër-Thuman, Cudhi, Bubq dhe Nikël**.

Bashkia Krujë, nga momenti i konstituimit të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive, ushtron të drejtën e pronësisë, si dhe të drejta të tjera, në përputhshmëri me mënyrat e përcaktuara me ligj. Referuar, Kreut IV, (*Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme*), pika 3, të Udhëzimit nr. 510, datë 0.06.2015, ku thuhet:

*Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike, brenda datës 31.12.2015, duhet të dërgojë informacion të plotë, pranë çdo bashkie, në lidhje me pronat që janë transferuar ndër vite te NJSH-të.*

Sipas dokumentacionit të paraqitur nga Drejtoria e Administrimit të Territorit, Aseteve dhe Pasurive të Paluajtshme të Bashkisë Krujë, akoma deri në këto momente, nuk ekziston një informacion i tillë.

Po ashtu, në këtë drejtori, akoma shërben si inventar pronash të trashëguara nga ish njësitë vendore, regjistrat e pronave bashkëngjitur VKM-ve, për kalimin në pronësi të qeverive vendore, deri në vitin 2011, në kundërshtim kjo me Pikën 4, të Kreut IV, të Udhëzimit nr. 510, datë 0.06.2015, ku thuhet:

*Zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme duhet të reflektojë ndryshimet përkatëse në regjistrat e pasurive të paluajtshme, sipas ligjit nr. 115/2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë". Në përfundim të regjistrimit të pronave, në emër të bashkisë, ZRPP-ja dërgon dokumentacionin e përditësuar pranë çdo bashkie, por jo më vonë se 1 vit nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.*

Konkretisht, në mungesë të dokumentacionit sa sipër, nga DATAPP-ja Krujë, përdoren si inventarë pronash, dokumentacioni si më poshtë:

- Për ish Bashkinë Fushë-Krujë, lista e pronave sipas VKM nr. 1264, datë 17.09.2008.
- Për ish Komunën Kodër Thumanë, lista e pronave sipas VKM nr. 454, datë 06.05.2009.,
- Për ish Komunën Bubq, lista e pronave sipas VKM nr. 712, datë 20.10.2011.
- Për ish Komunën Nikël, lista e pronave sipas VKM nr. 109, datë 17.02.2010.
- Për ish Komunën Cudhi, lista e pronave sipas VKM nr. 172, datë 13.02.2008, por e veçantë për këtë njësi është fakti se i kanë kaluar në pronësi vetëm lista e pyjeve e kullotave, ndërsa me VKM nr. 422, datë 8.04.008, ku është evidentuar lista e inventarit të pronave, nuk cilësohet kalimi në pronësi, por ngelen thjesht në juridiksion të asaj ish njësie vendore, pra për atë inventar pronash, nuk është përcaktuar pronësia.

Sipas dokumentacionit të paraqitur nga Drejtoria e Administrimit të Territorit, referuar pasqyrave të pasurisë, në ish njësitë vendore sa sipër, është mbajtur një *Procesverbal datë 14.06.2016*, ku janë evidentuar sipas listës së objekteve respektive, objektet me problematike si: **-objekte të shkatërruara, -objekte të zaptuara, -pasuri të shkatërruara dhe të tjetërsuara me ndërtime të pa ligjshme.**



Për sa sipër, me *Informacionin e datës 28.06.2016*, nga kjo drejtori, i është bërë e ditur Kryetarit të Bashkisë Krujë, problematika e konstatuar, ndarë sipas secilës njësi vendore.

*Nga sa rezulton, nuk është marrë ndonjë nismë nga strukturat e Bashkisë Krujë, për rikuperimin e situatës, evidentimin e dëmeve të konstatuara si dhe marrjen e masave për administrimin sipas ligjit, të aseteve sipas listës bashkëngjitur informacionit sa sipër.*

Për të paraqitur konkretisht situatën aktuale të pronave të trashëguara nga ish njësitë vendore, për të cilat nuk është bërë e mundur evidentimi i dëmeve, si dhe administrimi dhe menaxhimi, po japim në mënyrë të detajuar pasqyrat sa më poshtë:

***Për NJSH-në Fushë-Krujë***, rezulton se që nga momenti i marrjes në dorëzim, sipas Procesverbalit të datës 14.06.2016, në këtë njësi vendore, janë evidentuar të zaptuara dhe për të cilat nuk është marrë asnjë masë, duke sjell pasoja me ***dëm ekonomik nga të ardhurat e munguara***, nga keq menaxhimi i tyre për:

***Sipërfaqe Trualli të zaptuara 2,225,1 m<sup>2</sup>.***

***Sipërfaqe Objektiv të zaptuara 2,111,2 m<sup>2</sup>.***

***Për NJSH-në Thumanë***, rezulton se që nga momenti i marrjes në dorëzim, me procesverbalin e datës 14.06.2016, në këtë njësi vendore, janë evidentuar të zaptuara dhe për të cilat nuk është marrë asnjë masë, duke sjell pasoja me ***dëm ekonomik nga të ardhurat e munguara***, nga keq menaxhimi i tyre për:

***Sipërfaqe Trualli të zaptuara 7,484 m<sup>2</sup>.***

***Sipërfaqe Objektiv të zaptuara 1,095 m<sup>2</sup>.***

***Për NJSH-në Nikël***, rezulton se që nga momenti i marrjes në dorëzim, me procesverbalin e datës 14.06.2016, në këtë njësi vendore, janë evidentuar të zaptuara dhe për të cilat nuk është marrë asnjë masë, duke sjell pasoja me ***dëm ekonomik nga të ardhurat e munguara***, nga keq menaxhimi i tyre për:

***Sipërfaqe Trualli të zaptuara 57,137 m<sup>2</sup>.***

***Sipërfaqe Objektiv të zaptuara 11,090 m<sup>2</sup>.***

***Për NJSH-në Bubq***, rezulton se që nga momenti i marrjes në dorëzim, me procesverbalin e datës 14.06.2016, në këtë njësi vendore rezultojnë:

- Prona të zaptuara, -objekte të shkatërruara, për të cilat nuk është marrë asnjë masë, duke sjell për pasoj ***dëm ekonomik nga të ardhurat e munguara***, shkatërrimi i pronës, si dhe nga keq menaxhimi i tyre për:

***Sipërfaqe Trualli të zaptuara 11,002 m<sup>2</sup>.***

***Sipërfaqe Objektiv të zaptuara 600 m<sup>2</sup>.***

***Nga Bashkia Krujë***, prej momentit të konstituimit, nuk është marrë asnjë nismë ligjore për lirimin e pronave të zëna, sipërfaqe ndërtim të zaptuara si dhe sipërfaqet e 15 objekteve të shkatërruara, ***duke krijuar dëm ekonomik të llogaritur***, nga shkatërrimi i pronës si dhe nga të ardhurat e munguara nga keq menaxhimi i tyre, prej dy vjetësh, në total për pasuritë e zaptuara sa më poshtë:

- Truall i zaptuar gjithsej **455,213.3 m<sup>2</sup>.**

- Sipërfaqe objektiv të zaptuara **15,528.4 m<sup>2</sup>.**

- Sipërfaqe e 15 objekteve të shkatërruara **10,557 m<sup>2</sup>.**

***Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:***

1. Ligjin 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

2. VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar, në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-teritorjal”.

3. VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”.

4. Udhëzimin e KM nr. 3, datë 18.07.2002 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”.

5. Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

6. Udhëzimi i Përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit të Financave, nr.3237 datë 16.07.2015.

7. Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

8. “Rregullore mbi Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Bashkisë Krujë dhe Njësive Administrative”, miratuar me VKB Krujë nr. 6, datë 29.01.2016.

**Titulli i Gjetjes:** Nga momenti i marrjes në dorëzim, me procesverbalin e datës 14.06.2016, të pronave nuk është marrë asnjë nismë ligjore për lirimin e pronave të zëna.

- **Situata:** Në NJSH-në Krujë, Fushë-Krujë, Thumanë, Nikel, Bubq që nga momenti i marrjes në dorëzim, me procesverbalin e datës 14.06.2016, në këtë njësi vendore me procesverbalin e datës 14.06.2016, nuk është marrë asnjë nismë ligjore për lirimin e pronave të zëna, sipërfaqe ndërtim të zaptuara si dhe të shkatërruara, në total janë si më poshtë:

- Truall i zaptuar gjithsej **526,325,3 m<sup>2</sup>**.

- Sipërfaqe objektesh të zaptuara **30,424,6 m<sup>2</sup>**.

- Sipërfaqe e 15 objekteve të shkatërruara **10,557 m<sup>2</sup>**.

**Kriteri:** Kreut IV, (Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i Pasurive të paluajtshme), pika 3, të Udhëzimit nr. 510, datë 0.06.2015, UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**Ndikimi/ Efektit:** Pasojat që kanë ardhur janë të medha si: Pronat zaptohen në mënyrë të pa ligjshme dhe mund tjetërsohen. Nuk mund të jenë si burim të ardhurash mosvënia në efience të këtyre pronave. Sa më shumë kohë kalon, veshtersia për zgjidhjen e çështjeve të pronave do të rritet për zgjidhjen e problemeve të tyre.

**Shkaku:** Mosvenia para pergjegjesisë dhe mungesa e kërkesës llogarisë nga drejtuesit Për zbatimin e ligjit, si dhe mungesa e fondeve për regjistrimin e pronave në ZRP.

**Rëndësia:** I lartë.

**1.-Rekomandime:** Drejtoria e Administrimit të Aseteve dhe Drejtoria Juridike, në Bashkinë Krujë, të marinë masa të menjëhershme për riinventarizimin e objekteve sipas Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, sa më sipër, dhe të nisë menjëherë procedura ligjore për lirimin e pronave të zaptuara, llogaritjen e dëmit ekonomik nga shkatërrimi i pronës për **10,557 m<sup>2</sup>** ish objekte, si dhe nisjen e procedurave ligjore për vjeljen e detyrimit nga dëmet e krijuara.

**2.-Rekomandime:** Nga Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Aseteve dhe Drejtoria Juridike, pasi të jenë ri inventarizuar pasuritë e zaptuara sa sipër: në zbatim të VKM nr.510, datë 10.6.2015, të evidentohen subjektet që posedojnë ato pasuri dhe të nisin procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa shlyera të qirave si dhe lidhjen e kontratave të reja të qirave, në të kundërt lirimin e pronës.

### III.5 KONSOLIDIMI FINANCIAR (Kreu VII, i VKM)

-Dorëzimi brenda dy muajve nga konstituimi i organeve të bashkisë pasqyrat financiare të njesive që shkrihen të cilat përfshijnë tërësinë e aktivitetit të tyre deri në datën e funksionimit Nga verifikimi i dokumentacionit financiar të njesive që shkrihen konstatohet se janë dorzuar në Drejtorinë e Financës pas konstituimit, por ato janë dorzuar me vonesë dhe jo në arkiven e bashkisë.

-Verifikimi i Pasqyrave Financiare të konsoliduara (Bilancin kontabël të konsoliduar) duke përfunduar, kështu bashkimin financiar të bashkisë. (Prezantimi i pasqyrave financiare para shkrirjes dhe mbas konsolidimit, analiza e zërave kryesorë të pasqyrave për Bashkinë Krujë, Fush-Krujë dhe 4 ish komunat: **Kodër Thumanë, Cudhi, Bubq dhe Nikël**).

**Objekti i këtij aktverifikimi është:** “Konsolidimi Financiar” për vitet 2014, korrik 2015, në ish Bashkinë Fush-Krujë dhe në 4 ish Komunat Thumanë, Bubq, Nikel, Cudhi, sot egzistojnë si Njësi Administrative”.

Nga verifikimi rezultoi se:

***-Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.***

***-Në lidhje me mënyrën e bashkimit të aktivitetit të ish-Komunave me Bashkinë si rezultat i Reformës Territoriale dhe zbatimi i procedurave të caktuara me VKM nr. 510, datë 10.06.2015.***

Bazuar në VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo territorial” nga Bashkia Krujë dhe Njësitë Administrative Fushë-Krujë, Kodër Thumanë, Bubq, Nikël dhe Cudhi si trashëgimtarë të ish-komunave kanë organizuar punën dhe kanë kryer këto detyra:

- Kryetari i Bashkisë bazuar në ligjin nr. 8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ndryshuar me ligjin nr. 9208, dt.18.03.2004 dhe të ligjit nr. 30/2015, si dhe për përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në VKM nr. 510, datë 10.06.2015 ka nxjerrë Urdhrin nr. 81, datë 15.09.2015 për ngritjen e Grupit të Punës: Gj.B. (Kryetar i grupit punës) me detyrë nën/Kryetar, R.S. me detyrë përgjegjëse Finance e Bashkisë Qendër, Xh.Xh. me detyrë përgjegjëse finance e Bashkisë Fushë Krujë, M.D. me detyrë Drejtor i Burimeve Njerzore Bashkia Fushë Krujë, A.H. me detyrë juriste, E.S. me detyrë Drejtore juridike, R.B. me detyrë inspektore personeli, A.D. me detyrë Drejtore e Planifikimit Urban, L.P. financiare.

- Për Hartimin e pasqyrave Financiare Ministria e Financave në kuadrin e projektit “Star” të financuar nga ana e saj për mbështetje të njësive vendore pas Reformës Territoriale ka organizuar trajnime për punonjësit qendër Bashkie procedurat dhe teknikat e realizimit të bashkimit të aktiveve të njësive vendore të shkruara për finalizimin e tyre në konsolidimin e llogarive në pasqyrat financiare.

- Nga Njësitë Vendore që janë shkruar është bërë transferimi i të drejtave dhe detyrimeve në Bashkinë Krujë në bazë të pasqyrave financiare të dorëzuar nga ish komunat.

- Pranë Sektorit të Burimeve Njerzore të Bashkisë Krujë nga Njësitë Vendore që janë shkruar janë depozituar për administrim i gjithë dokumentacioni i personelit me dosjet individuale të punonjësve që ishin në marrëdhënie pune në momentin e konstituimit.

- Bashkia Krujë për aktivet të përfshira në inventar dhe kontabilitetin e njësive vendore të shkruara ka organizuar dhe ka kryer nëpërmjet komisioneve të inventarizimit inventar fizik të pjesshëm në fund të vitit 2016, Inventari është kryer për aktivet: Ilog. 214-Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune, Ilog. 215-Mjete transporti, Ilog. 218-Inventar ekonomik, Ilog.31-Materiale dhe Ilog. 32-Objekte inventari nuk janë inventarizuar aktivet: Ilog. 202-Studime dhe kërkime, Ilog. 230-Shpenzime për rritjen e aktiv. qëndrueshme. Patrupëzuara për Ilog. 210-Toka, troje, Terrene, Ilog. 211- Pyje, Kullota Plantacione, Ilog. 212 -Ndërtime e Konstruksione dhe Ilog. 213 -Rrugë, rrjete, vepra ujore aktivet të qëndrueshme të trupëzuara dhe patrupëzuara.

- Bashkia Krujë nëpërmjet Sektorit të Financës dhe bashkëpunimit të ish-punonjësve të financës të njësive vendore të shkruara të cilat kanë depozituar pasqyrat financiare të vitit 2015 pranë këtij Sektori ka realizuar konsolidimin e pasqyrave financiare trajtuar më hollësisht tek trajtimi i pasqyrave financiare.

***-Në lidhje me rregullshmërinë dhe ligjshmërinë e administrimit të aktiveve, saktësinë e mbajtjes së ditarëve për azhurnimin e veprimeve ekonomike rezultoi që:***

Administrimi i aktiveve, qarkullimi dhe kontabilizimi i tyre është bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, në ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, VKM nr.83, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2007 për institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhim/zbatimit të Projekteve e Marrëveshjeve me Donatorë të huaj” të ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007.

Mbajtja e kontabilitetit është realizuar me regjistrimet në ditar, duke i kontabilizuar në llogaritë përkatëse të gjitha veprimet dhe faktet ekonomike që i përkasin kësaj njësie shpenzuese.

Janë mbajtur libri i arkës për arkëtimet dhe pagesat, ditari i bankës, ditari i magazinës, librat e pagave, ditari i veprimeve të ndryshme, kartelat e llogarive si dhe janë hartuar pasqyrat financiare vjetore. Për çdo regjistrim kontabël janë shënuar origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimit ekonomik dhe kontabilizimi i veprimeve është bërë në llogaritë përkatëse bazuar në planin kontabël.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël. Kontabilizimi i të ardhurave për Bashkinë Krujë, mbajtja e kontabilitetit të ardhurave është bërë nga Drejtoria e Tatim Taksave. Çdo regjistrim kontabël bëhet sipas mandat-arkëtimeve të bankës. Kontabilizimi të ardhurave është bërë i saktë në llogaritë e klasës 7 sipas llojeve të ardhurave të kryera nëpërmjet Bankës është realizuar në ditarin e Bankës. Për të ardhurat e arkëtuara nëpërmjet Arkës evidentohen në librin e arkës sipas mandat arkëtimeve dhe kryqëzohen me fatura për arkëtim të lëshuar nga Drejtoria e Tatim Taksave. Drejtoria e Tatim taksave evidenton dhe kontabilizon të gjithë llojet e të ardhurave të kryera nëpërmjet Bankës dhe Arkës e cila finalizohet me akt-rakordimin me Thesarin Dega Krujë.

### **Hartimi i Pasqyrave Financiare të Konsoliduar Bashkia Krujë.**

*-Në lidhje me hartimin e pasqyrave financiare për veprimtarinë ekonomike të Bashkisë dhe cilësisë së informacionit kontabël të pasqyruar në to rezultoi se:*

Për vitin 2013, 2014 deri me 30.06.2015 janë hartuar pasqyrat financiare dhe janë depozituar pranë degës së Thesarit Krujë duke respektuar afatin ligjor të përcaktuar. Pasqyrat financiare për ish Bashkinë dhe ish komunat janë mbyllur me 07.07.2015 dhe janë dorëzuar në Thesar në afat me shkresë përcjellëse. Aktivi dhe pasivi i bilancit është i kuadruar, pavarësisht se informacioni kontabël që mbartin ato nuk është i saktë, pasi pasqyrat Financiare të ish-komunave mbartin pasaktësi në pozicionimin e gjendjeve të llogarive kontabël si dhe në disa raste nuk paraqesin gjendjen reale të aktiveve e për pasojë dhe të fondeve bazë. Përsa i përket formateve anekse të pasqyrave financiare të plotësuara nga ish-**komunat kanë pasaktësi**, pavarësisht që mund të rakordojnë në gjendjen përfundimtare me aktivin dhe pasivin e bilancit për llogaritë analoge, por pasqyrimi i lëvizjeve është bërë i gabuar. Pasqyrat e shpenzimeve të ushtrimit dhe pasqyra e të ardhurave të ushtrimit kuadrojnë me akt-rakordimet me thesarin për shpenzimet dhe për të ardhurat. Gjithashtu gjendjet e llogarive në pasqyrën e lëvizjeve në “CASH” rakordojnë me akt-rakordimet me thesarin. Gjendja e llogarisë “Teprica në mbyllje të ushtrimit” është e barabartë me gjendjen e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në aktivin e bilancit.

-Për Njësinë Administrative Thumanë nuk janë mbajtur regjistrat e aktiveve si dhe përlllogaritja e amortizimit është bërë në total.

Pasqyrat përmbledhëse të bilanceve 2013,2014, 30.06.2015 dhe bilanci i konsoliduar 2015 për Njësit dhe Bashkinë Krujë, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nga analiza e llogarive të aktivitetit dhe pasivit të bilanceve 2013, 2014-2015 të ish Bashksë Fushë-Krujë dhe ish Komunat si dhe bilancit të konsoliduar të vitit 2015, të dorëzuar në thesar si rezultat i reformës territoriale rezultoi se:

#### **Në Aktivin e Bilancit**

Gjendja e llogarisë 202 “Studime e projekte” ka pësuar rritje në vlerën totale 2,373,844 lekë. Kjo gjendje e shtuar përbëhet nga: vlera prej 580000 lekë përfaqëson rritjen në Bashkinë qendërnë ish-Bashkinë Fushë Krujë prej 1036644 lekë, për ish-komunën Nikël prej 283200 lekë për ish-komunën Bubq, prej 474000 lekë. Gjendja e llogarisë 230 “Shpenzime për rritjen e aktiv. qendr. patrupsëzuar” kjo llogari nuk ka patur ndryshime. Gjendja e llogarisë 210

“Toka, troje, terrene” nga viti 2014 në 2015, nuk ka pësuar ndryshim. Gjendja e llogarisë 211 “Pyje , kullota e plantacione”, në vitet objekt kontrolli 2014, 2015 është rritur në vlerën 549600 lekë për ish Bashkinë Fushë-Krujëqë përfaqëson pemë e lule dekorative. Gjendja e llogarisë 212 “Ndërtime e konstruksione” ka pësuar rritje në fund të vitit 2014 në krahasim me vitin 2015 në shumën prej 14738844lekë. Gjendja e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” për vitin 2014 krahasuar me vitin 2015 ka pësuar rritje në shumën prej 44119513 lekë. Gjendja e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” për vitin 2014 krahasuar me vitin 2015 ka pësuar rritje në vlerën 4788795 lekë. Gjendja e llogarisë 215, “Mjete transporti” për vitin 2014 krahasuar me vitin 2015 ka pësuar rritje në vlerën 14650903lekë. Gjendja llogaria 218 “Inventar ekonomik” për vitin 2014 krahasuar me vitin 2015 ka pësuar rritje në vlerën 12351776lekë. Analiza për ndryshimin e aktive të qëndrueshme janë të analizuara për cdo rast për vetëm në ish komunën Thumanë, ku nuk janë mbajtur rregjistrat e aktiveve sipas analizës. Gjendja e llogarisë 311 “Materiale” për vitin 2014 krahasuar me vitin 2015 ka pasur paksim në shumën 2381310lekë. Gjendja e llogarisë 327 “Objekte inventari” për vitin 2014 krahasuar me vitin 2015 ka pasur paksim në shumën 1637112 lekë. Gjendja e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin(debitor)” për vitin 2014 krahasuar me vitin 2015 ka pasur rritje në shumën 15883701lekë. Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqitet me të gjendje në fund të vitit 2014 në shumën 153 975 590 lekë, ndërsa në fund të vitit 2015 në shumën 221838008 lekë është rritur për shumën 71335588 lekë. Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” paraqitet me gjendje për vitin 2014 në vlerën 156 471 251 lekë, kjo shumë përfaqësohet grand + të ardhura që trashëgohen për vitin 2015, si dhe kreditorët për mjet në ruajtje që për vitin 2014 janë në shumën 14 898 120 lekë që janë 5% e garancisë së punimeve. Për vitin 2015 paraqitet me gjendje në vlerën 84 082 637 lekë; kjo shumë përfaqësohet grand + të ardhura që trashëgohen për vitin 2016, si dhe kreditorët për mjet në ruajtje që për vitin 2015 janë në shumën 33734899lekë që janë 5% e garancisë së punimeve. Gjendja e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” për vitin 2014 krahasuar me vitin 2015 ka pasur paksim në shumën 69184517lekë.

### **Në Pasivin e Bilancit:**

Llogaria 419 “Kliente (Kreditorë), parapagesë pjesore” në fund të vitit 2015 paraqitet me gjendje 0 leke. Llogaria 401 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në mbyllje të vitit 2014, paraqitet në shumën 67621056 lekë, shumë e cila përfaqëson furnitorë të ndryshëm, detyrime etj, të cilat janë trashëguar për vitin 2015, në mbyllje të vitit 2015 paraqitet në shumën 85934648 lekë për vitin 2014, krahasuar me vitin 2015, ka pasur rritje në shumën 18313592 lekë. Kjo tregon se detyrimi kundrejt furnitorëve janë rritur për këtë shumë. Llogaria 42 “Personeli e llogari të lidhura me to” në mbyllje të vitit 2014, paraqitet në shumën 15485803 lekë, shumë e cila përfaqëson detyrimet ndaj personelit në mbyllje të vitit 2015 paraqitet në shumën 17473453 lekë, për vitin 2014 krahasuar me vitin 2015, ka pasur rritje në vlerën 1987650 lekë. Kjo tregon se detyrimi kundrejt personelit janë shtuar për këtë shumë. Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa”, në mbyllje të vitit 2014, është në shumën 457289 lekë, në fund të vitit 2015 në shumën 486810 lekë që përfaqësojnë tatim në burim. Llogaria 435 dhe 436 “Sigurime shoqërore dhe shëndetësore” paraqesin detyrimet kundrejt Sigurimeve Shoqërore për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të pa derdhura dhe janë përkatësisht 4627335 lekë, 623576 lekë, në fund të vitit 2014. Në fund të vitit 2015 detyrimet për sigurime shoqërore është në vlerën 4449653 lekë dhe 598628 ka një pakësim krahasuar me vitin 2014, në vlerën 202630 lek. Llogaria 466 “Kreditor për mjetet në ruajtje”, e cila përfaqëson shumën 5% ndalur për garanci punimesh në fund të vitit 2014 paraqitet në bilanc në vlerën 14898120 lekë dhe në fund të vitit 2015 paraqitet në bilanc në shumën 33734899 lekë, krahasuar vitin 2015 me vitin 2014 kanë rritje në shumën 18836779 lekë. Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqitet në fund të vitit 2014 me gjendje 64481145lekë në fund të vitit 2015 në shumën 60239098 lekë, krahasuar vitin 2015 me vitin 2014 kanë paksim në vlerën 4242047

lekë. Logaria 475 “Të ardhura për tu regjist.vitet pasardhëse” paraqitet në fund të vitit 2014 në shumën 26500036 lekë dhe në fund të vitit 2015 në shumën 0 lekë.

Me integrimin e pasqyrave financiare të njëjshme të shkruara me pasqyrat e veta (të bashkisë qendër), Bilanc i konsoliduar që rregullisht duhet të përfaqësojë bashkimin financiar të Bashkisë Krujë për vitin paraqiten këto probleme:

1. Në disa njësi nuk ka analiza të llogarive: llog.202, llog. 218 (Njësia Thumanë).
2. Në disa njësi nuk ka paraqitje të sakta të posteve të bilancit(Krujë, Nikël, Bubq).
- 4.Paraqiten gabime teknike në pasqyrimin e aktiveve në llogaritë përkatëse, duke u pozicinuuar në llogaritë jo të duhura. Kjo ka patur efekt se në përlllogaritjen e normave të amortizimit koficientët janë të ndryshëm, kështu që kjo nuk paraqet një gjendje reale të konsumit të aktiveve (Njësia Thumanë).
- 5.Nga ish komuna Thumanë nuk janë mbajtur rregjistrat e aktive si dhe mungojnë analizat përkatëse të llogarive.
- 6.Nga ish komuna Thumanë dhe Cudhi për vitet 2014-2015, nuk janë kontabilizuar debitorët në bilancet respektive.

***Për të gjitha mangësitë e trajtuara, për ish Komunën Thumanë mban përgjegjësi ish përgjegjësi i financës z. Bardhok Doda.***

#### **Inventarizimi i aktiveve.**

*-Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se:*

Në bazë të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik” Bashkia Krujë, nuk ka kryer procesin e inventarizimit të aktiveve për vitin 2015. Në fund të vitit 2016 është kryer procesi i inventarizimit për Bashkinë Krujë dhe Njësitë Administrative trashëgim të ish-komunave Fushë-Krujë, Thumanë, Bubq, Nikël, Cudhi me urdhrin e titullarit nr. 543, datë 24.11.2016 është ngritur komisioni për inventarizimin e aktiveve. Hartimi i bilancit konsoliduar është bërë me gjendjen kontable. Rezultatet e inventarizimit janë pasqyruar në kontabilitetin e vitit 2017.

**Titulli i Gjetjes:** Nga NJSH-të Thumanë dhe Cudhi për vitet 2014-2015, nuk janë kontabilizuar debitorët në bilancet respektive, nuk ka analiza të llogarive: llog. 202,llog. 218 Hartimi i bilancit konsoliduar është bërë me gjendjen kontable, jo sipas vlerës inventareve.

**Situata:** Në bazë të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik” Bashkia Krujë, nuk ka kryer procesin e inventarizimit të aktiveve për vitin 2015. Në fund të vitit 2016 është kryer procesi i inventarizimit për Bashkinë Krujë dhe Njësitë Administrative trashëgim të ish-komunave Fushë-Krujë, Thumanë, Bubq, Nikël, Cudhi me urdhrin e titullarit nr. 543, datë 24.11.2016 është ngritur komisioni për inventarizimin e aktiveve. Hartimi i bilancit konsoliduar është bërë me gjendjen kontable.

Rezultatet e inventarizimit pasqyruar në kontabilitetin e vitit 2017.

Pasqyrat Financiare të NJSH-ve mbartin pasaktësi në pozicionimin e gjendjeve të llogarive kontabël si dhe në disa raste nuk paraqesin gjendjen reale të aktiveve e për pasojë dhe të fondeve bazë.

**Kriteri:** Si bazë ligjore për auditimin jemi bazuar në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 , UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, VKM nr. 510, datë 10.06.2015, urdhrin e titullarit nr. 543, datë 24.11.2016 është ngritur komisioni për inventarizimin e aktiveve, UMF nr. 26, datë 27.12.2007.

**Ndikimi/Efektit:** Mos saktësimi i vlerës së aseteve sipas vlerave të inventarëve, krijon premisa për mos njohjen reale e gjendjes financiare dhe fizike të aseteve, të cilat janë burimi i të ardhurave.

**Shkaku:** Kjo ka ndollur për paaftësi profesionale dhe mungesës së kërkesës llogarisë ndaj specialisteve dhe komisionit të inventarëve.

**Rëndësia:** I mesëm

**1.-Rekomandime:** -Nga Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Aseteve dhe Drejtoria Juridike, pasi të jenë ri inventarizuar pasuritë e zaptuara sa sipër, të evidentohen subjektet që posedojnë ato pasuri dhe të nisin procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa shlyera të qirave si dhe lidhjen e kontratave të reja të qirave, në të kundërt lirimim e pronës.

**2.- Rekomandime:** -Të analizohet kjo gjendje lidhur me moskryerjen e inventarëve, të nxirret përgjegjësia e mos kryerjes së inventarizimit dhe mos nxjerrës së rezultatit të tij. Të kryhet inventarizimi sipas legjislacionit në fuqi sa më parë:

#### ***Sqarime për Akt-Konstatimet e mbajtura.***

Për sa mësipër është mbajtur *Akt Konstatimi nr.1, datë 18.09.2017*, ku sipas Procesverbalit date 14.06.2016 janë evidentuar sipas listës së objekteve respective, objekte me problematik si: -Objekte të shkatërruara, objekte të zaptuara nga qytetarë, pasuri të shkatërruara dhe të tjetërsuara me ndertime të pa ligjshme nga këto:

Truall i zaptuar gjithsej 526,325,3 m<sup>2</sup>

Sipërfaqe objektësh të zaptuara 30,424,6 m<sup>2</sup>

Sipërfaqe e 15 objekteve të shkatërruara 10,557 m<sup>2</sup>

Nuk ka komente dhe shpjegime nga subjekti.

#### ***Qëndrimi i grupi të KLSH:***

*Janë lenë rekomandime që të inventarizohen pronat e Bashkisë dhe të vihen para përgjegjësive Punonjësit e Drejtorisë së Administrimit të pronave publike që nuk zbatojnë detyrimet që kanë.*

Për sa mësipër është mbajtur *Akt Konstatimi nr.2, datë 27.09.2017* dhe për këtë çështje subjekti i audituar me shkresën nr.5678/1, date 03.10.2017 ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Në faqen 3, të këtij Akt-Konstatimi: Ju shpreheni se njoftimi për shkurtimin e vendeve të punës nga riorganizimi është berë një muaj me vonesë, ky njoftim është berë në muajin Tetor, duke tejkaluar afatin e njoftimit të shkurtimit të vendeve të punës.

Me Urdhër nr.1817, datë 15.09.2015 është berë ngritja e grupit punës i cili është përgjegjës për zbatimin e procedurave që rrjedhin nga zbatimi i ligjit nr.30/2015 dhe si pasojë me date 01.10.2015 janë berë njoftimet për shkurtime të vendeve të punës.

Për mungesë të infrastrukutës Bashkisë Krujë është berë marrveshje verbale me Arkiven e Shetit Vendor, Durrës është vendosur që dokumentacioni NJSH-ve pasi të përpunohet të dorëzohet pranë ASHV-së Durrës.

#### ***Qëndrimi i grupi të KLSH:***

*Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, Qendrimi i audituesit lidhur me pagesat e mësipërme është në kundërshtim me pikës 1, kreu IV "Transferimi i personelit" VKM Nr.510, datë 10.6.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuarra dhe të patrupëzuarra, të arkivave dhe çdo dokumenti zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial" ku shrehet se:*

*Konstituimi i organeve të Bashkisë Krujë dhe marrja e mandatit të Kryetarit janë realizuar me datë 30.07.2015, kështë që në zbatim të VKM Nr.510, datë 10.6.2015. Marrëdhëniet e punës ekzistuese, ndërmjet NJSH-ve dhe punonjësve të tyre, do të transferohen në Bashki, në momentin e konstituimit të organeve të saj. Nga momenti i konstituimit deri në miratimin e strukturës administrative përfundimtare, bashkia është në proces ristrukturimi dhe operon me strukturë transitore, e cila miratohet nga kryetari i saj, **brënda 1 muaji nga marrja e mandatit.***

*Prandaj ku koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.*

*Megjithese Vendimi i Këshillit Bashkisë Krujë Nr.49, datë 31.08.2015 "Për ristrukturimin e numërit të punonjësve" është marrë brenda muajit nga marrja e mandatit të kryetarit, pra*

*brenda afatit të pëcaktuar në Kreu IV, të VKM Nr.510, datë 10.6.2015, njoftimi për shkurtimin e punonjësve është marrë me datë 29.09.2015, pra një muaji me vonesë, sipas përcaktimit të VKM Nr.510, datë 10.6.2015, për shkak e struktura tranzitore është miratuar me urdhërin nr.71, datë 15.09.2015 me 263 punonjës gjithsej, ndarë kjo në 59 punonjës me status Nepunesi Civil dhe 214 punonjës me kontratë.*

*Qëndrimi i Adudituesi është se: nuk justifikohet pagesat e punonjësve sipas VKM Nr.510, datë 10.6.2015*

Për sa më sipër është mbajtur **Akt Konstatimi nr.3, datë 03.10.2017** për NJSH-në Thumanë dhe për këtë çështje subjekti i audituar me shkresë nr.5679/7, datë 03.10.2017 ka **bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:**

Në mungesë të infrastruktures së arkivës NJSH-në Thumanë dhe në marrveshje verbale me Arkiven Shtetërore Vendore Durrës është vendosur që i gjithë dokumentacioni i NJSH-vë pasi të pëpunohet të dorzohen pranë ASHV-së Durrës.

Punonjësit specialist arkive në NJSH-së Thumanë është paguar sipas strukturës së miratuar me Urdhër nr.49, datë 31.08.2015 si dhe strukturës me Urdhër nr.71, datë 15.09.2015.

**Qëndrimi i grupi të KLSH:**

*Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, Qëndrimi i audituesit lidhur me pagesat e mësipërme dokumenton se janë në kundërshtim me legjislacioni në fuqi dhe përben shkelje të pikës 3, Kreu V “Transferimi i Arkivave dhe Dokumentacionit” të VKM nr. 510, datë 10.6.2015 ku shprehet se:*

*Dokumentet në ruajtje të përkohshme, për të cilat nuk ka përfunduar afati i ruajtjes, duhet të vazhdojnë të ruhen pranë NJSH-së deri në transferimin pranë Bashkisë, pasi të jenë krijuar hapësirat e nevojshme. Për këtë, arkivat e NJSH-ve mund të vazhdojnë të ekzistojnë edhe më pas konstituivit të bashkisë, por, gjithsesi, por jo më shumë se 6 muaj nga ky moment.*

*Në këto kushte mbajtja e organikës së arkivit të NJSH-ë është në shkelje të VKM nr. 510, datë 10.6.2015 dhe përbën dem ekonomik në vlerën 425,920, për të cilën ky vendim është shprehur në pikën 6 Kreu II, që përbën shkelje administrative.*

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.4, datë 27.09.2017 dhe për këtë çështje subjekti i audituar me shkresën nr.5680/1, date 03.10.2017 ka bërë **komente dhe shpjegime dhe konkretisht:**

Në zbatim të shkresave Nr. 319/10,, datë 06.07.2015 dhe shkresës Nr. 251/11, datë 13.06.2016 nga punonjësit e arkivave të NJSH-ve Fushë Krujë dhe Thumanë kanë bërë përpunimin tekniko shkencor, pjesërisht janë dorëzuar pranë ARSH vendore Durrës, punonjësit e arkivave janë paguar sipas strukturës së miratuar me Urdhërin Nr. 49, datë 31.08.2015 si dhe strukturës me Urdhër nr. 71, datë 15.09.2015.

**Qëndrimi i grupi të KLSH:**

*Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, Qëndrimi i audituesit lidhur me pagesat e mësipërme është në kundërshtim me pikën 3, të Kreu V, të VKM nr. 510, datë 10.6.2015 ku shprehet se: Arkivat e NJSH-ve mund të vazhdojnë të ekzistojnë edhe pas konstituivit të bashkisë, por, gjithsesi, por jo më shumë se 6 muaj nga ky moment. Në këto kushte mbajtja e organikës së arkivit të NJSH-ë është në shkelje të VKM nr. 510, datë 10.6.2015 dhe përbën dem ekonomik në vlerën 519,870 lekë nga NJSH-ja Fushë-Krujë, pagesa e saj deri në fund të vitit 2016 që është dhe afati i periudhës së audituar.*

## **REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIME:**

***Për permirsimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:***

1. - Të inventarizohen të gjitha asetet e luajtshme dhe të pa luajtshmet të Bashkisë Krujë.
2. - Të ngrihet Grupi i inventarizimit nga titullari me specialitë të fushës përkatëse.
3. - Inventari duhet të kryhet menjëherë.



***Regjistrimi i pronave në Zyrën e Regjistrimit Pronave ZRPP (hipoteka).***

4. -Të plotësohet dosja e pronave me gjithë dokumentacionin ligjorë që kërkohej nga zyra e Regjistrimit Pronave, dhe të dërgohen për regjistrimin e tyre në ZRPP.
5. -Drejtoria e Administrimit të Aseteve dhe Drejtoria Juridike, në Bashkinë Krujë, duhet ta organizojë dhe të kryej gjithë procedurat deri në regjistrimin e pronave në ZRPP.
6. -Ky proces duhet të kryhet brenda 6 muajve të parë të vitit 2018.

***Transferimi i arkivave të NJSH-ve në Bashkinë Krujë.***

7. -Të marrin të gjitha masat për transferimin e arkivave të NJSH-ve në Bashkinë Krujë.
8. -Drejtoria e Burimeve Njerzore që ka në vartësi këtë sektor të organizojë dhe kryej këtë detyrë.
9. -Procesi i transferimit të dosjeve duhet të përfundojë menjëherë.

***Të nderpriten mardheniet e punë së arkivisteve të NJSH-ve Fushë-Krujë, Thumanë.***

10. -Në zbatim të VKM nr. 510, datë 10.6.2015, të shkurtuhet organika e arkivisteve të NJSH-ve Fushë-Krujë, Thumanë.
11. -Titullari i Bashkisë së bashku me Drejtorin e Burimeve Njerzore të marrin masa të menjëhershme për shkurtimin e organikës së arkivave në NJSH-ve Fushë-Krujë, Thumanë.
12. -Shkurtimin e organikës së arkivave të NJSH-ve Fushë-Krujë, Thumanë të kryhet menjëherë

***Të kryhet procesin e inventarizimit të aktiveve për çdo vitë e të pasqyrohet rezultati në bilancin e vitit.***

13. -Të kryhet procesin e inventarizimit të aktiveve për çdo vitë, rezultati i tij të pasqyrohet në bilancin e vitit
14. -Drejtorija e Finances dhe Buxhetit në Bashkinë Krujë
15. -Të kryhet inventarizimi menjëherë në fund të këtij viti dhe të shprehet rezultati në bilancin e fundit vitit 2017.

***Miratimi me vonësë i buxhetit***

15. -Të miratohet buxheti i vitit sipas përcaktimit Ligjorë.
16. -Drejtorija e Finances dhe Buxhetit dhe keshilli i Bashkisë, mbajnë përgjegjësi për miratimin në afat të buxhetit.
17. Këshilli i qeverisjes vendore, duhet ta miratojë buxhetin brenda datës 31 Dhjetor të vitit 2017, sipas nenin 32 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008.

***Hartimi i buxhetit dhe zbatimi i tij sipas rregullave, procedurave dhe afateve të përcaktuara***

18. -Në hartimin e buxhetit të përfshihen detyrimet që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formësë prerë, likuidimi i detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore për largimet nga puna të punonjësve, duhet të kryhet pasi të dalë akti i titullarit që provon gjurmen e auditimit të këtij procesi, njëkohësisht ky detyrim duhet të kryhet sipas rradhës dhe në mënyrë propocionale për sejcilin punonjës.
19. -Titullari në bashkeveprim me Drejtorinë e Finances dhe Buxhetit, Drejtorin e Burimeve Njerzore dhe Sektorin e Auditit duhet ta kryej këtë detyrim.
20. -Duhet të zbatohen çdo viti dhe rast pas rasti sipas detyrimeve që ka Bashkia në hartimin e tij.

***-Mbikqyrja e vendimeve dhe veprimeve të menaxherëve.***

21. -Kërkohej që të mbikqyren dhe të raportohet lidhur me mbikqyrjen menaxheriale, duke i përfshirë me objektivitet vlersimin e punonjësve mbi abtimin e detyrimeve që kanë punonjësit.

22. -Titullari i Bashkisë Krujë.

23. -Në menyrë të vazhdueshme dhe për çdo punonjes që ka perfituar statusin e NC.

## **PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.**

**1.1-Rekomandimi:** -Të shtohen në legjislacion aktual, kompetencat e Administratorëve të njësive Administrative ku të përfshihen tagra Vendimmarrëse e Administratorëve lidhur kryesisht në fushën e mbrojtjes dhe emergjencave civile si dhe përdorimin e një pjesë të fondeve që krijohet në njësinë Administrative mbi planin e të ardhurave të planifikuara, për zgjidhjen e kërkesave dhe nevojave emergjente e të domosdoshme të banorëve.

### **B. MASA ORGANIZATIVE**

**1.-Gjetje nga auditimi:** Për zbatimin e Reformës Territoriale nga ana e Bashkisë Krujë konstatohet se nuk është hartuar një program pune i detajuar, për të gjitha problemet dhe personat përgjegjës duke identifikuar problemet dhe personat që do të ndiqnin problemin deri në zbatimin e plotë të tyre. Faktin që për identifikimin e pronave dhe regjistrimin e pronave nuk janë përcaktuar detyra konkrete për çdo punonjës tregon që ka munguar një organizimi dhe kërkesa e llogarisë për zbatimin e VKM nr. 510, datë 10.6.2015.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën III. Mbi Përputhshmërinë e Procesit të Transferimit të Drejtave dhe Detyrimeve të Prekura nga Riorganizimin Administrativo-Territorial faqe 24-26 të Raportit Përfundimtarë )*

**1.1-Rekomandimi:** -Nga ana e Titullarit Bashkisë të merren masa konkrete, për hartimin e dosjeve të pronave dhe regjistrimin e tyre në hipotekë, për këtë të detyrë të behet organizimi i punonjësve dhe caktimi i detyrave për çdo punonjës.

menjëherë

**2.-Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të kryer nga ana e auditeve të KLSH, nuk u identifikua asnjë raportim në mënyrë periodike të përgatitur nga grupet e punës në Bashkinë Krujë, për të identifikuar problemet, mangësitë që kanë ndikuar në mos implementimin e saktë e të plotë të reformës territoriale, pra në zbatimin të pikës 3, të Kreut II të VKM nr. 510, datë 10.6.2015.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.1 Transferimi i të Drejtave dhe Detyrimeve (KREU III, i VKM) faqe 26-28 të Raportit Përfundimtarë )*

**2.1-Rekomandimi:** - Për të arritur rezultate në zbatimin e reformës territoriale, kërkohet që detyrat e ngarkuar në fushën e reformës të auditohen dhe të vihen para përgjegjësive punonjësive që nuk kryejnë detyrat e ngarkuar sipas urdhrave të titullarit dhe rregullores së kësaj bashkie.

menjëherë

**3.-Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se roli e funksionimi i grupit të punës nuk ka qenë funksionale, efçente në kryerjen e funksioneve që i janë ngarkuar, si për zbatimin e procedurave dhe detyrimet që rrjedhin nga riorganizimi i pushtetit vendorë në zbatim të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”i ndryshuar, ashtu dhe të raportimit në mënyrë periodike tek kryetari i bashkisë për zbatimin e detyrave dhe problemeve që kanë rezultuar në lidhje me riorganizimin.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.1 Transferimi i të Drejtave dhe Detyrimeve (KREU III, i VKM) faqe 26-28 të Raportit Përfundimtarë )*

**3.1-Rekomandimi:** - Strukturat përgjegjëse për zbatimin e VKM nr.510, datë 10.6.2015 në Bashkisë Krujë, të kryjnë një analizë të plotë për mos zbatimin e këtij vendimi dhe të nxirret

përgjegjësia materiale dhe administrative sipas përcaktimit të pikës 6 të Kreut II të VKM nr. 510, datë 10.6.2015.

menjëherë

**3.2-Rekomandimi:** - Bashkia Krujë, të marrë masa për verifikimin në teren të statusit juridik të aseteve të qëndrueshme sipas listës të miratuar me VKM nr.433, datë 08.06.2016 dhe të veprohet sipas procedurave ligjore:

**a.** Në rastet kur asetet posedohen nga persona të tretë, të paautorizuar, të lajmërohen personat dhe të lidhen kontrata qiraje për trojet e lira, ndërtesat dhe trojet funksionale, duke kërkuar arkëtimin e të ardhurave të munguara.

**b.** Në rast se nuk arrihet marrëveshje me personat përkatës, të bëhet denoncim në organet kompetente të zbatimit të ligjit dhe të veprohet në bashkëpunim me strukturat e Bashkisë, Policinë Bashkiake për lirimin e aseteve të zëna forcërisht dhe të vihen këto në posedim të Bashkisë si pasuri në shërbim të komunitetit.

menjëherë

**4.-Gjetje nga auditimi:**Parregullsi në realizimin e të ardhurave nga pasuritë, mos inventarizimi pasurive të NJSH-ve, është si pasojë e pa përgjegjshmërisë manaxheriale të sektorëve përkatës në Bashkinë Krujë.

Një situatë e tillë, ka sjell për pasojë, *mungesë mbikëqyrje dhe keq menaxhim*, të aseteve të Bashkisë Krujë. (Më hollësisht trajtuar në pikën I. Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli i Brendshëm, faqe 5-13 të Raportit Përfundimtarë )

**4.1-Rekomandimi:** - Mbas ri-inventarizimit të pasurive të trashëguara nga ish NJSH-të, të merren masat për regjistrimin e këtyre pasurive në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme, si dhe menaxhimi i tyre sipas llojit.

në vijimësi

**5.-Gjetje nga auditimi:** Referuar Procesverbalit datë 14.06.2016, të Drejtorisë së Administrimit të Aseteve, rezulton vetëm një listë me Objekte të shkatërruara, objekte të zaptuara dhe troje me ndërtime të paligjshme, të trashëguara nga ish Komunat.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III. 4 Transferimi I Pasurive Dhe Regjistrimit Te Pasurive Te Paluajtshme (Kreu Vi, I VKM) në faqen 48 të Raportit Përfundimtarë )

**5.1-Rekomandimi:** - Drejtoria e Administrimit të Aseteve dhe Drejtoria Juridike, në Bashkinë Krujë, të marrin masa të menjëhershme për riinventarizimin e objekteve sa sipër, dhe të nisë menjëherë procedura ligjore për lirimin e pronave të zaptuara, llogaritjen e dëmit ekonomik nga shkatërrimi i pronës për **10,557 m<sup>2</sup>** ish objekte, si dhe nisjen e procedurave ligjore për vjeljen e detyrimit nga dëmet e krijuara.

në vijimësi

**6.-Gjetje nga auditimi:** Referuar po Procesverbalit datë 14.06.2016, të Drejtorisë së Administrimit të Aseteve, evidentohet parregullsi lidhur me mos zbatimin e ligjshmërisë në zbatimin e procedurave ligjore, për transferimin e pasurive të pa luajtshme, nga riorganizimi administrativo-territorial, në Bashkinë Krujë.

Si pasojë e kësaj parregullsie, rezulton një dëm ekonomik i llogaritur, nga keq menaxhimi i pronës në mos vjeljen e të ardhurave nga:

- Truall i zaptuar gjithsej **455,213.3 m<sup>2</sup>**.

- Sipërfaqe objektesh të zaptuara **15,528.4 m<sup>2</sup>**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.4 Transferimi i Pasurive Dhe Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme (Kreu Vi, I Vkm) faqe 49-50 të Raportit Përfundimtarë )

**6.1-Rekomandimi:** - Nga Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Aseteve dhe Drejtoria Juridike, pasi të jenë ri inventarizuar pasuritë e zaptuara sa sipër, të evidentohen subjektet që posedojnë ato pasuri dhe të nisnin procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa shlyera të qirave si dhe lidhjen e kontratave të reja të qirave, në të kundërt lirimin e pronës..

**7.-Gjetje nga auditimi:** Sipas dokumentacionit të paraqitur nga Drejtoria e Administrimit të Territorit Aseteve dhe Pronave, në Bashkinë Krujë, për listat e objekteve, prona të trashëguara në këtë Bashki, nuk figurojnë kontrata qiraje me subjektet që i posedojnë ato, para dhe pas konstituimit të Bashkisë Krujë (*Më hollësisht trajtuar në pikën X të Raportit Përfundimtarë* )

**7.1-Rekomandimi:** - Drejtoria e Administrimit të Territorit Aseteve dhe Pronave, mbasi të evidentoj në teren objektet, sipas listës së pronave të regjistruara, të lidhë menjëherë kontratat e qerasë me subjektet të cilat i posedojnë, duke llogaritur edhe detyrimet për pagesat, në periudhat e mëparshme.

menjëherë

**8.-Gjetje nga auditimi:** Me VKM nr. 1264, datë 17.09.2008, janë miratuar në pronësi të Bashkisë Krujë, prona të pa luajtshme; objekte ndërtimore sheshe dhe troje etj, sipas fushave përkatëse të përdorimit të pronës; administratë, arsim, shëndetësi, kulturë, sport, funeral, zhvillim ekonomik etj.

Për këto pasuri të pa luajtshme, nuk është aplikuar në ZVRPP Krujë, për të realizuar regjistrim e tyre në pronësi të Bashkisë, në kundërshtim me ligjin nr. 33-2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të nenit 9, pika 1.2 dhe neni 27, pika 5, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të **kap. III**, pika 20, 21, 22, 30, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar. Nga Bashkia Krujë, nuk është kryer inventarizimin e tyre në vite dhe nuk dihet statusi juridik aktualë i tyre *Më hollësisht trajtuar në pikën X faqe të Raportit Përfundimtarë* ).

**8.1-Rekomandimi:** -Bashkia Krujë, të marrë masa për verifikimin në teren të statusit juridik të aseteve të qëndrueshme sipas listës të miratuar me *VKM nr.510 , datë 10.06.2015* dhe të veprohet sipas procedurave ligjore:

**a.** Në rastet kur asetet posedohen nga persona të tretë, të paautorizuar, të lajmërohen personat dhe të lidhen kontrata qiraje për trojet e lira, ndërtesat dhe trojet funksionale, duke kërkuar arkëtimin e të ardhurave të munguara.

**b.** Në rast se nuk arrihet marrëveshje me personat përkatës, të bëhet denoncim në organet kompetente të zbatimit të ligjit dhe të veprohet në bashkëpunim me strukturat e bashkisë, Policinë Bashkiake për lirimin e aseteve të zëna forcërisht dhe të vihen këto në posedim të bashkisë si pasuri në shërbim të komunitetit.

në vijimësi

**9.-Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kryer në arkivat e NJSH-ve, Nikël, Bubq, Cudhi konstatohet se dokumentacioni i këtyre subjekteve (NJSH-ve) deri më sot, **nuk kanë arkivuar pranë arkivava shtetërore vendore**, sipas juridiksionit territorial si dhe pranë bashkisë Krujë ky qëndrim është në kundërshtim me përcaktimin e pikës 2, Kreu V, të VKM nr. 510, datë 10.6.2015 ku shprehet se : *NJSH-të, përpara datës së dorëzimit të dokumentacionit pranë bashkisë, duhet të kenë përfunduar përpunimin për dokumentacionin e viteve të mëparshme, përfshirë atë të vitit 2014. Përpunimi apo klasifikimi sipas fondeve duhet të kryhet në përputhje me normat teknikeprofesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë (Më hollësisht trajtuar në pikën III.1 Tranferimi i të Drejtave dhe Detyrimeve (KREU III, i VKM) faqe 27-32 të Raportit Përfundimtarë* ).

**9.1-Rekomandimi:** - Bashkia Krujë të marrë masa të menjëhershme për transferimin e dokumenteve arkivore, pasi të jenë të sistemuara dhe inventarizuara sipas *pikës 2 e 3 të Kreut V, të VKM nr. 510, datë 10.6.2015*, si dhe të dorëzohen për ruajtje dhe administrim pranë arkivave shtetërore vendore, sipas juridiksionit territorial përkatës.

menjëherë

**9.2-Rekomandimi:** -Të analizohen nga ana Titullarit Bashkisë arsyet e mos transferimit të dokumentacioneve arkivore sipas juridiksionit territorial, si dhe pranë Bashkisë Krujë, si dhe të nxirret përgjegjësia sipas përcaktimit të pikes 6 të Kreut II të VKM nr. 510, datë 10.6.2015.

menjëherë

**10.-Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2016 është ngritur komisioni për inventarizimin e aktiveve në Bashkinë e Krujës , por nuk është kryer inventarizimi në kundërshtim me pikën 73, 78, Inventarizimi periodik i aktiveve të UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”. Hartimi i bilancit të kosoliduar në Bashkinë Krujë është bërë me gjendjen kontabile, pasi nuk ka pasur rezultate të inventarizimit në Njësitë Administrative trashëgim të ish-komunave Fushë-Krujë, Thumanë, Bubq, Nikël, Cudhi dhe Bashkinë Krujë (Më hollësisht trajtuar në pikën Pasivi i bilancit faqe 56 të Raportit Përfundimtarë ).

**10.1-Rekomandimi:** - Të analizohet kjo gjendje lidhur me moskryerjen e inventarëve, të nxirret përgjegjësia e mos kryerjes së inventarizimit dhe mos nxjerres së rezultatit të tij. Të kryhet inventarizimi sipas legjislacionit në fuqi sa më parë:

menjëherë

**11.-Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i buxhetit të Bashkisë Krujë, konstatohet se miratimi i tyre është bërë bërë me shumë vonesë si: Në Bashkinë Krujë në vitin 2014 është miratuar me Vendimin e Këshillit nr. 9, datë 13.3.2014, në vitin 2015 është miratuar me Vendimin nr. 7, datë 17.02.2016, duke shkelur afate e përcaktuara në nenin 32 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 ku shprehet se: Këshilli i qeverisjes vendore, brenda datës 31 Dhjetor, miraton buxhetin vendor në bazë të vlerësimit të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor. Në këto kushte miratimi me vonesë e buxhetit, ka sjellë vonesa dhe në vendimmarrje, që duhej të kryhet në kohë si për përcaktimin e numrin e punonjësve,pagat, strukturën organizative të Bashkisë shpenzimeve, investimeve dhe të ardhurave (Më hollësisht trajtuar në pikën II. Mbi Zbatimin e Buxhetit të Ish-Bashkisë Fushë Krujë dhe ish Komunave. faqe 13-14 të Raportit Përfundimtarë ).

**11.1-Rekomandimi:** -Bashkisë Krujë të marrë masat e nevojshme që të mundësohet miratimi i buxhetit në afatet e përcaktuara në ligje, që vendimmarrja të vendosë në aftësi optimale për problemet që lidhen me buxhetin në Bashkinë Krujë.

menjëherë

**12.-Gjetje nga auditimi:** Programimi i buxhetit, është element i rëndësishëm për të siguruar efektshmërinë e funksionimit të institucionit, por konstatohet se nuk ka qenë aq i mbështetur në burimet, fakt që vërtetohet nga ndryshimet që kanë ndodhur gjatë periudhës dhe transferimi i fondeve nga një zë në një zë tjetër të artikujve buxhetor. Shpenzimet e institucionit për paga, sigurime shoqërore, në vitin 2015 janë planifikuar më tepër se nevojat në vlerën 21,711 mijë lekë kështë që janë planifikuar 204,996 mijë lekë dhe janë realizuar 183,285 mijë lekë, ndersa në vitin 2016 janë planifikuar 260,935 mijë lekë dhe janë realizuar 240,381 mijë lekë, me një kursim prej 20,554 mijë lekë ose në nivelin 92%. Mos realizimin më të lartë e ka zëri paga dhe sigurime që reflekton ose një programim të fryrë të strukturave ose risk operacional për sa kohë ka vende vakante në strukturën e institucionit, duke shkelur pikën 83, “Numëri i punonjësve buxhetorë” të udhëzimit Nr.2, datë 06.02.2012: Numëri i punonjësve në organikë, për njësitë qeverisjes qëndrorer, është përcaktuar në ligjin vjetorë të buxhetit (Më hollësisht trajtuar në pikën II. Mbi Zbatimin e Buxhetit të Ish-Bashkisë Fushë Krujë dhe ish Komunave, faqe 24-30 të Raportit Përfundimtarë )

**12.1-Rekomandimi:** - Procesi i programimit buxhetor të udhëhiqet nga analiza të kujdesshme të nevojave dhe burimeve ligjit buxhetit dhe udhëzimeve përkatëse, sipas kushteve në të cilat do të realizohet ky buxhet. Kjo kërkon diskutim më të mbështetur dhe me transparencë të procesit, i cili do të ndihmojë arritjen e një programimi realist sidomos kur i referohemi burimeve njerëzore që sigurojnë realizimin e produkteve buxhetore.

në vijimësi

**13.-Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i shpenzimeve të realizuara u konstatua një zë i konsiderueshmen lidhur me ekzekutimin i vendimeve gjyqësore të formës prerë, për largimet nga puna të punonjësve. Vetëm në një vit paguhen rreth 8,676,168 lekë si pasojë e largimeve pa zbatuar kriteret e përcaktuara në *ligjin nr. 152/2013, datë 01.10.2013 “Për Nëpunësin Civil”* i ndryshuar VKM e Udhëzimet e KM e DAP për zbatimin e këtij ligji si dhe Kodin e Punës për punonjësit me Kontratë. Konstatohet së për periudhën e audituar janë larguar në vitin 2015 rreth 134 punonjës dhe janë marrë në punë në vitin 2016 Bashkisë Krujë 52 punonjës, duke mos u marrë dhe dorëzuar detyra sipas kërkesave të VKM nr. 7, datë 09.01.1976 “Për dorëzimin e detyrës midis punonjësve”, fakt që tregon mungesë e proceseve të largimit nga puna të punonjësve por edhe motivimin e drejtë të këtyre lëvizjeve (*Më hollësisht trajtuar në pikën II. Mbi Zbatimin e Buxhetit të Ish-Bashkisë Fushë Krujë dhe ish Komunave, faqe 20-25 të Raportit Përfundimtarë* )

**13.1-Rekomandimi:** -Titullari i institucionit të vlerësojë dhe ndjekë një politikë të kujdesshme në rastet e largimeve nga puna për të mos pasur kosto shtesë për fondet buxhetore. Për çdo vendim gjyqësor që prek fondet buxhetore të ketë analizë të përgjegjësive administrative për mos veprime në përputhje me kërkesat e ligjit në largimin e punonjësve nga puna. Marrja dhe dorëzimi dhe marrja e detyrës të kryhet konformë legjislacionit në fuqi.

në vijimësi

**14.-Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i gjendjes së llogarive rezultoi se: gjendja në llogarinë nr.4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”, është në vlerën 4,653,765 lekë, kjo tregon se nuk janë marrë masat e duhura për zgjidhjen ligjore të këtij detyrimit zbatim të gërmës a) e pikës 5, të Udhëzimit nr.1, datë 04.06.2014 ku shprehet se: “*Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore që janë parashikuar të shlyhen nga buxheti përkatës , bëhet sipas rradhës së paraqitjes zyrtare të tyre në vitin paraardhës dhe grafiku i shlyerjes behet publik nëpërmjet publikimit në faqen on-realizohen të njësisë shpenzuese”* (*Më hollësisht trajtuar në pikën II. Mbi Zbatimin e Buxhetit të Ish-Bashkisë Fushë Krujë dhe ish Komunave, faqe 27-28 të Raportit Përfundimtarë* ).

**14.1-Rekomandimi:** -Bashkia Krujë nëpërmjet auditimit Financiar, të përcaktojë shkaqet e krijimit të këtij detyrimi, kohën e krijimit, duke u bazuar në dokumentacionin kontabël dhe mbi këtë bazë të dalë me konkluzione e vendime konkrete për sistemimin e detyrimit të mësipërm dhe pergjegjesia e krijimit të ketyre detyrimeve.

me miratimin e buxhetit për vitin 2018

**15.-Gjetje nga auditimi:** Rezultoi se, në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, nga NJSH-të e BashkisëKrujë , nuk janë zbatuadetyrimet ligjore në implementimit e sistemeve të përshtatshme të menaxhimit financiar dhe kontrollit si, lidhur me këtë nuk është hartuar një sistem rregullash dhe procedurash në NJSH-të e Bashkisë Krujë, nuk është hartuar plani strategjik, nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut, nuk është hartuar plani i veprimeve për arritjen e objektivave, nuk është ngritur grupi i menaxhimit strategjik ku në krye të jenë drejtuesit e NJSH-ve. Veprimi dhe mosveprimi është kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (*Më hollësisht trajtuar në pikën I. Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli i Brendshëm, faqe 5-13 të Raportit Përfundimtarë* ).

**15.1-Rekomandimi:** - Bashkisë Krujë, të marrë masa për implementimin e kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” sipas shkeljeve të konstatuara gjatë auditimit.

në vijimësi

**16.-Gjetje nga auditimi:** Referuar të dhënave të bilancit të konsoliduar të Bashkisë Krujë, më datën 31.12.2016, rezulton “rritje në total e shpenzimeve operative” në shumën **84,596 mijë lekë** (Më hollësisht trajtuar në pikën III.5 Konsolidimi financiar (kreu II, i VKM) menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm. faqe 51-55 të raportit përfundimtarë).

**16.1-Rekomandimi:** -Drejtoria ekonomike, të marrë në analizë dhe të reduktojë shpenzimet operative, veçanërisht në llogaritë e shpenzimeve për : “mallra dhe shërbime shëndetësore”, “Transferata korente të brendshme”, “transferata për familjet dhe individët”, si dhe “shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme”.

në vijimësi

**17.-Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatue se nuk janë hartuar dhe analizuar Vlerësimi i përmbajtjes së Raportit mbi çështjet operacionale, si: strukturat administrative dhe përgjegjësitë; disponueshmëria e shërbimeve publike dhe funksioneve administrative; inventari i sistemeve të informacionit dhe kontratave të mirëmbajtjes; vlerësimi i kontrolleve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) të zbatuara në sistemet e informacionit; inventari i pajisjeve të TI-së dhe marrëveshjeve të komunikimit; procedurat e arkivimit të dokumentacionit; menaxhimi i aktiveve; projektet e investimit; kontratat e shërbimeve publike; kontratat me palët e treta; çështjet gjyqësore (Më hollësisht trajtuar në pikën III.1 Transferimi i të Drejtave dhe Detyrimeve (KREU III, i VKM) faqe 25-28 të Raportit Përfundimtarë ).

**17.1-Rekomandimi:** -Nga ana e Drejtuesve të Bashkisë të merren masa dhe të analizohen problemet që janë konstatuar si: Meqenëse hardëareve janë të vjetëruar të parashikohet investime për blerjen dhe zëvendësimin e hardëareve të vjetër,të krijohet një sektor me specialist të TI-së, bashkia duhet të krijojë infrastrukturën fizike për arkivën dhe të implementojë arkivat elektronike. Të zbatohen detyrat e përcaktuara nga VKM nr.510, datë10.6.2015 lidhur me arkivat. Transferimi i arkivave në vende të miratuara sipas ligjit.

në vijimësi

**18.-Gjetje nga auditimi:** Në rregulloren e Bashkisë Krujë konstatohet se nuk përcaktohen qartë ndarja e funksioneve të politik-bërjes dhe monitorimit të kryerjes me cilësi të shërbimeve dhe dhënien e tyre, si dhe përshkrimi ligjorë i kryerjes së detyrës nga punonjësit e Bashkisë Krujë (Më hollësisht trajtuar në pikën V. Të tjera që do të dalin gjatë auditimit. Faqe 59-60 të Raportit Përfundimtarë )

**18.1-Rekomandimi:** -Të rihartohet një rregullore e Bashkisë Krujë ku të përcaktohet qartë funksionet e çdo vendi pune, baza ligjore të drejtat dhe detyrimet e tyre, të kërkohet që drejtuesit organizativ të mbajnë përgjegjësi për hartimin dhe monitorimin e politikave si dhe zbatimin e tyre.

menjëherë

## **A. MASA ADMINISTRATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi :** Grupit i punës, i ngritur për zbatimin e procedurave të transferimit në bashki, është ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 81, datë 15.09.2015 i cili përbehet nga 9 punonjës, e drejtohet nga nënkryetari i saj, ka në përbërje, të paktën, një përgjegjës financë, një jurist, një specialist të arkivit dhe një specialist të burimeve njerëzore, ky grup pune ka pasur si qellim zbatimin e procedurave të transferimit të punonjësve, pronave, dokumenteve e arkivave etj, këto detyra që i janë ngarkuar nuk janë zbatuar sa e si duhet, duke mos zbatuar pikën 2, Kreu II, i VKM nr. 510, datë 10.6.2015.

Grupi i punës nuk ka raportuar në mënyrë periodike tek kryetari Bashkisë sipas përcaktimit të pikës 3, Kreu II, i VKM nr. 510, datë 10.6.2015. Nuk u kanstatue bashkërendimi i punëve nga ana e drejtuesit me Agjencinë e Zbatimit të Reformës Territoriale, kjo mangësi tregon se nuk janë zbatuar kriteret e përcaktuara në pikën 4, Kreu II, i VKM nr. 510, datë 10.6.2015 (*Më hollësisht trajtuar në pikën III. Mbi Përputhshmërinë e Procesit të Transferimit të Drejtave dhe Detyrimeve të Prekura nga Riorganizimin Administrativo-Territorial, faqe 24- 27 të Raportit Përfundimtarë*).

**1.1-Rekomandimi:** - Për Mospërmbushje të detyrimit për bashkë-punim dhe informim, në zbatim të nr. 510, datë 10.6.2015, në mbështetje të pikës 6 të Kreut II të VKM nr. 510, datë 10.6.2015, I propozojmë Kryetarit Bashkisë të marrë masë administrative ndaj Grupit të punës.

menjëherë

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga Bashkia Krujë, janë paguar punonjësit që janë parashikuar të shkurohen nga puna një muaj më tepër, nga këto 18 punonjes me SNC dhe 116 punonjës me kontratë si rezultat i vonesës prej një muaji të njoftimit për largimin nga puna si rezultat të ristrukturimit të bashkisë Krujë. **Vlera prej 3,728,760 Lekë**, e cila përfaqëson pagesën e punonjësve një muaj më tepër se sa e ka përcaktuar VKM Nr.510, datë 10.6.2015, do të konsiderohet si dëm ekonomi shkaktuar Buxhetit të Shtetit.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2 Transferimi i personelit (Kreu IV, i VKM) faqe 30- 42 të Raportit Përfundimtarë* )

**2.1- Rekomandimi:** - Në mbështetje të pikës 6, të Kreut II të VKM nr. 510, datë 10.6.2015, i propozojmë Kryetarit Bashkisë të marrë masë administrative ndaj punonjësve që e kanë pasur si detyrë të zbatonin sipas pikës 1, kreu IV “Transferimi i personelit”. të VKM nr. 510, datë 10.6.2015.

menjëherë

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i arkivave të NJSH-ve, Nikël, Bubq, Cudhi konstatohet se edhe sot në muajin shator të vitit 2017, dokumentacioni i ketyre subjekteve deri më sot nuk është arkivuar në pranë arkivave shtetërore vendore, sipas juridiksionit territorial si dhe pranë Bashkisë Krujë si dhe nuk është kryer përpunimi i tyre sipas viteve sipas pikës 2, Kreu V, të VKM nr. 510, datë 10.6.2015 ku shprehet se : *NJSH-të, përpara datës së dorëzimit të dokumentacionit pranë bashkisë, duhet të kenë përfunduar përpunimin për dokumentacionin e viteve të mëparshme, përfshirë atë të vitit 2014 (Më hollësisht trajtuar në pikën III.3 Transferimi i arkivave (KREU V, I VKM) faqe 44- 45 të Raportit Përfundimtarë*).

**3.1- Rekomandimi:** -Përpunimi apo klasifikimi sipas fondeve duhet të kryhet në përputhje me normat teknike profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, të miratuara me vendimin nr. 1, datë 16.1.2004, të Këshillit të Lartë të Arkivave, në mbështetje të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”. Në kryerjen e këtij procesi, NJSH-të do të mbikëqyren nga arkivi shtetëror vendor përkatës, sipas pikës 3, Kreu V, Transferimi i Arkivave dhe Dokumentacionit e VKM nr. 510, datë 10.6.2015 ku shprehet se “Dokumentet arkivore, të sistemuara dhe inventarizuara sipas pikës 2, me mbarimin e afatit të shërbimit operativ pranë NJSH-së, do të dorëzohen për ruajtje dhe administrim pranë arkivave shtetërore vendore, sipas juridiksionit territorial përkatës.

menjëherë

**3.2- Rekomandimi:** -Për mos zbatimin sipas pikës 3, Kreu V, Transferimi i Arkivave dhe Dokumentacionit e VKM nr. 510, datë 10.6.2015, *mbeshtetur në pikën 6 të Kreut II të VKM nr. 510, datë 10.6.2015. I propozojmë Kryetarit Bashkisë të marrë masë administrative ndaj punonjësve që e kanë pasur si detyrë të zbatonin Kryetrai i Bashkisë të marre masa administrative në mbeshtetje të*

menjëherë



## **A. KONKLUZIONE DHE OPINION AUDITIMIT**

Zbatimi i ligjit nr.115/2014, “Për ndarjen administrativa- territoriale të njësive vendore në Republikën e Shqipërisë” në Bashkinë Krujë ka pasur ndikim pozitiv në drejtim të shkurtimit të numërit të punonjësve me 81 persona, rritja e të ardhurave tatimore në vitin 2016 me mbi 81 milion lekë në krahasim me vitin 2014.

Por konstatohet se megjithëse shpenzimet për vitin 2016 janë realizuar në masën 85.6%, ose në vlerën 188.736 mijë lekë më pak, ato janë rritur në krahasim me vitin 2014 në vlerë prej 94,596 lekë, nga këto: rritje të shpenzimeve ka pasur në fondin e pagave, në vlerën 47,554 mijë lekë dhe në mallrat dhe shpenzime në vlerën 29,716 lekë. Për këto rritje të shpenzimeve nuk është dokumentuar asnjë analizë, si dhe nuk ka argumente për planifikimin jo reale nga specialistet.

Për zbatimin e Reformës Territoriale nga ana e Bashkisë Krujë konstatohet se nuk është hartuar një program pune i detajuar, për të gjitha problemet dhe personat përgjegjës duke identifikuar problemet dhe personat që do të ndiqnin problemin deri në zbatimin e plotë të tyre.

Grupi i punës i ngritur për të siguruar zbatimin e transferimit të të drejtave dhe detyrimeve nuk i ka ndjekur të gjitha detyrat e përcaktuara në VKM nr. 510, datë 10.6.2015.

Faktin që identifikimi, inventarizimi dhe regjistrimin e pronave nuk është kryer akoma deri më sot, tregon se punonjësit e ngarkuar për kryerjen hipotekimit të pronave ruajtjen dhe administrimin e tyre, nuk është kryer, tregon se: Nuk janë zbatuar Vendimet e KM për zbatimin e Reformes Administrativo-Territoriale, pasi konstatohet se akoma punonjësit nuk i kanë të përcaktuar detyra konkrete, ka munguar organizimi, dhe konstatohet një mungesë të theksuar të kërkesës llogarisë për zbatimin e VKM nr. 510, datë 10.6.2015, në drejtimin e administrimit të aseteve.

Nga auditimi konstatohet se: nga aktiviteti i kryer në këtë bashki, mungojnë analiza të thelluar dhe nxjerrja e përgjegjësive si për shkeljet e konstatuar ashtu dhe në mos përmbushjen e detyrimeve nga reforma administrativo-territoriale, në fushen e arkivave, në fushen e realizimit të ardhurave, organizimit i sistemit të grumbullim të taksave dhe tarifave si dhe në atë të ruajtjes ambientit dhe teritorit nga keqperdorimi.

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**